

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

***NËNË TEREZA – SHQIPTARJA
NGA SHKUPI***

(konferencë shkencore – 26.08.2015)

- 11 -



Shkup, 2015

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE –
SHKUP

Vëllimi 11 – 2015

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Sefer Tahiri

Këshilli redaktues:
Dr. Skender Asani
Dr. Sevdail Demiri
Dr. Zeqirija Ibrahimi
Dr. Naim Halimi

Sekretar i redaksisë:
Mr. Ardian Limani

Redaktor teknik:
Naser Fera

Copyright© ITSHKSH, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978 –608–4653–271

Botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH-së, nr.0201–211/8

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

***NËNË TEREZA – SHQIPTARJA
NGA SHKUPI***

(konferencë shkencore – 26.08.2015)

- 11 -

SCUPI

Shkup, 2015

TRYEZA E LËNDËS:

NËNË TEREZA–NJË SHEKULL DASHURI.....	7
DR. DON LUSH GJERGJI: FUQIA E FESË DHE FRYMËZIMI I DASHURISË – NËNA TEREZE.....	9
SKENDER ASANI: PRONËSIA E SHTËPISË SË GONXHE BOJAXHIUT (NËNË TEREZËS) – DËSHMI PËR SHQIPTARËSINË E SHESHIT TË SHKUPIT (DOKUMENT).....	20
PROF. DR. NEBI DERVISHI: NËNË TEREZA – NOBELISTJA SHQIPTARE NGA SHKUPI (ME RASTIN E 105 VJETORIT TË LINDJES – 26 GUSHT 1910 – 2015)	24
DR. SEFER TAHIRI: TENDENCAT PËR ZVETËNIMIN E IDENTITETIT ETNIK SHQIPTAR TË GONXHE BOJAXHIUT...	41
FADIL CURRI: PSE PO STRUKET HISTORIA SHQIPTARE E SHKUPIT?.....	54
DON VIKTOR SOPI: NËNË TEREZA NË VIZIONIN E PERSONALITETEVE BOTËRORE.....	57
MISIONET	63
PROPOZIM.....	69

NËNË TEREZA–NJË SHEKULL DASHURI



Para 105 viteve, në Shkupin tonë lindi njëra nga personalitetet më të mëdha botërore, figura universale—Gonxhe Bojaxhiu— Nënë Tereza. Një emër i madh, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për mbarë botën. Një humaniste e shquar, për të cilën nuk ka njeri në botë që nuk ka dëgjuar. Duke ndjerë rëndësinë dhe peshën historike që ka figura e saj, pikërisht në datën e lindjes së saj,

më 26 gusht të vitit 1910, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve—Shkup organizoi tribunën shkencore rreth jetës dhe veprës humane të përmasave planetare të Nënë Terezës. Në këtë tribunë me pikëpanjet e tyre u prezantuan studies të fushave të ndryshme, të cilët lartësuan figurën e Nënës Terezë.

Shqiptarët kanë më shumë nevojë për Nënë Terezën, se sa ajo për lartësimin e figurës së saj, andaj nisur nga ky fakt ne, bashkë—kombasit e saj, po veprojmë me krenari të jashtëzakontë për bijën më të madhe të kombit dhe me përkushtim të pashoq në zbardhjen e të panjohurave për Nënë Tereze.

Si asnjë person tjetër në botë, Nëna Tereze është figurë që flet fuqishëm edhe kur nuk është më ne mesin tonë dhe vazhdon të reflektojë dashurinë për të afërmit, tolerancën, paqen dhe solidaritetin. Kombi shqiptar i fali gjithë njerëzimit nënën që i mungonte dhe ajo na nxorri faqebardhë duke vazhduar mrekullitë shqiptare për njerëzimin. Rruga dhe veprimtaria e

saj vetëmohuese identifikohet edhe me fatin e vendit të saj për të cilin dha një kontribut të jashtëzakontë. Figura e saj dhe vlerat të cilat i përfaqësonte lidhen ngushtë me karakteristikat e kombit shqiptar ndër të cilat shquhet toleranca ndërfetare shqiptare e cila si urë lidhëse ndërshqiptare duhet të shërbejë si shembull për gjithë botën e mbarë për marrëdhënie konstruktive midis besimeve të ndryshme. Gjurmët që kjo bijë e kombit la në historinë e njerëzimit janë të pashlyeshme. Të frymëzuar nga Nietzsche—s që thoshtë: "Me të drejtë thuhet që një popull karakterizohet jo aq fort nga njerëzit e tij të mëdhenj, se sa nga ajo se si sillet ndaj tyre" po vazhdojmë përpjekjet e jashtëzakonta në promovimin dhe mbrojtjen e figures së Nënës Terezë.

Nëpërmjet botimit të një edicioni të veçantë rë revistës shkencore të Institutt të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve—Shkup "SCUPI" (vëllimi XI) vendosim vetëm një gurr të vogël në kalanë e botimeve të shumta për figurën e saj. Ky botim ka vlerë jo vetëm shkencore, por edhe shoqërore, pasi i njëjti synon që ta bëjë sa më publike idenë dhe nismën e Institutit të Trashëgimisë Shqiptërore dhe Kulturore të Shqiptarëve—Shkup, e cila në formë të propozimit zyrtar u është drejtuar institucioneve relevante vendore dhe qendrore. Instituti propozon që në vend të përmendores së lartë, që kushton disa miliona euro, në frymën e shpirtit dhe misionit të Nënës së Madhe Tereza, të rindërtohet shtëpia e saj e lindjes, natyrisht me dukjen e saj origjinale dhe autentike, shtëpi kjo e cila do të jetë dëshmi e kohës së lindjes së Gonxhe Bojaxhiut, por njëkohësisht do të jetë edhe urë lidhëse e gjithkohhme mes Nënës Terezë dhe Shkupit, mes saj dhe shqiptarëve, por edhe të tjerëve që jetojnë në kryeqendrën e Maqedonisë dhe në vendin tonë.

Këshilli redaktues i revistës "SCUPI"

DR. DON LUSH GJERGJI

Vikar Gjeneral i Ipeshkvisë së Kosovës

FUQIA E FESË DHE FRYMËZIMI I DASHURISË – NËNA TEREZE

Dashuria nuk bënë mrekulli, ajo është mrekulli në vazhdimësi. Këtë e vërteton jeta dhe vepra e së Lumes Nënës Tereze, si dhe e “Misionareve të Dashurisë”, të cilat sivjet kremtojnë 65 vjetorin e themelimit. Ato janë mbi 5000 murgesha me kushte të përjetshme rregulltare, në më se 150 shtete të botë, me më se 1000 kuvende rregulltare. Si ndodhi dhe vazhdon kjo “mrekulli” e fesë dhe dashurisë? Para se të shqyrtojmë rrethanat e kësaj ngjarjeje, duhet të themi se të gjithë ishin kundër qëndrimeve dhe veprimeve të Nënës Tereze, sidomos të themelimit të një rendi të ri rregulltar: Papa Piu XII, arqipeshkvi i Kalkutës Ferdinand Perier, eprorët e Motrave të Loretos, kushtet politike, ekonomik dhe shoqërore, Gandhi dhe gandizmi, që luftonte në mënyrë paqësore jodhunore sundimin e të bardhëve, ndasitë kastore në Indi. Megjithatë ndodhi mrekullia, ajo vazhdon gjithnjë në botë. E Varfëra ndër më të varfër, Nëna Tereze, ndihmon më së shumti gjithë ata që vuajnë në trup dhe në shpirt. Si? Me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë. Ajo thoshte: “*Kemi zemër për të dashur, duar për të shërbyer... Vetëm dashuria do ta shpëtojë botën... Pa dashuri dhe flijim jeta s’ka kuptim*”. Shumë studjues, biografë të Nënës Tereze, kanë shqyrtuar kushtet, rrethanat, motivet e braktisjes së saj nga bashkësia rregulltare e “*Motrave të Loretos*”, ku kishte kaluar 18 vite. Nga dëshmitë e saja, por edhe të eproreve dhe të bashkësisë,

Nëna Tereze si motër e Loretos kishte qenë shumë e lumtur dhe frytdhënëse, së pari si infermiere, pastaj si profesoreshë e historisë dhe gjeografisë, së fundi edhe si drejtoreshë e shkollës së tyre “St. Mary” në Kalkutë. Këtë e dëshmon edhe vetë Nëna Tereze në një letër shkruar “*Nënës Loke*” Drane Bojaxhiu dhe familjes: “*Jam mirë me shëndet. Po ua çoj këtë fotografi nga dita ime më e bukur e jetës, kur ia përkushtova tërë jetën time Krishtit. Lutni për mua. Të fala nga Gonxhja juaj – Tereza e vogël e Jezusit Fëmijë*” (Darjeeling, 23 maj 1929)¹.



Këtë kënaqësi dhe lumturi ajo e ka shprehur vazhdimisht të gjithëve, eproreve të “*Motrave të Loretos*”, bashkësisë rregulltare ku jetonte dhe vepronte, familjes së saj, mbi të gjitha njerëzve që i takonte dhe shërbente gjithnjë. Ja edhe një dëshmi me shkrim nga viti 1938 duke i shkruar “*Nënës Loke*” dhe Lazrit në Tiranë kështu: “*Më vjen keq që nuk*

¹ Don Lush GJERGJI, Nëna e Dashurisë, DRITA-VELAR, 2010, fq. 91.

*mund të jem pranë jush, por qëndro e lumtur, Nënë e dashur, nga që Gonxhja jote e dashur është e lumtur... Kjo është një jetë e re. Qendra jonë është shumë e bukur. Po jap mësim dhe e dua këtë punë. Unë jam edhe drejtoreshë e tërë shkollës dhe të gjithë më duan shumë këtu...”*². Gjatë një bisede me Nënë Tereze unë e pyeta përse dhe si erdhi deri te ky vendim, a mos ishte ndonjë krizë apo vështirësi në thirrje rregulltare. Ja përgjigjia e saj: *“Kurrë nuk kam pasur dyshim sa i përket thirrjes sime rregulltare. E ndieja thellë në zemrën time se Zoti më thërriste për një mision, jetë, punë tjetër, por unë nuk e dija dhe nuk e kuptoja pse dhe si”*³. Atit shpirtëror dhe rrëfyesit të saj pas ushtrimeve shpirtërore në Darjeelind, ndër të tjera i kishte thënë kështu: *“O Atë, e tëra ndodhi kështu: me 10 shtator, duke udhëtuar për në Darjeeling, një qytet i vendour nën Himalaje, në tren, dëgjova zërin hyjnor. Ishte kjo “thirrja në thirrje”, thirrja ime e dytë. Porosia ishte e qartë: duhej ta lëja kuvendin e Loretos që të isha në gjendje t’u pëkushtohesha plotësisht me tërë jetën time, të varfërve...”*⁴.

Pas botimit të parë në gjuhën anglishte, Mother Teresa, *Com By My Light, The Privat Writings of the “Saint of Calcutta”*, Braian Kolodiejchuk, MC, 2007, ky libër pati edhe shumë përkthime dhe botime pothuaj në të gjitha gjuhët e njohura botërore, duke zgjuar shumë kureshtje, reagime, dyshime, kritika, shqyrtime, qëndrime, vlerësime, gjykime, sulme, mbrojtje, befasi...

Përse është botuar ky libër?

² Po aty, vep. e cit. fa. 114.

³ Po aty, vep. e cit. fq. 117.

⁴ Po aty, fq. 130.

Për ta dhënë “*fytyrën*” e panjohur të Nënës Tereze sidomos gjatë viteve 1946–1950, kur përfundimisht mori pëlqimin dhe lejen e Romës për themelimin e Rregullit të ri të “*Misionareve të Dashurisë*”, si dhe jetën e mëvonshme të saj shpirtërore. Nga këto letra pjesërisht të panjohura dhe të pabotuara gjertani zbulojmë këto risi:

Deri me këtë botimim supozohej se Nëna Tereze gjatë udhëtimit në tren për Darjeelin më 10 shtator 1946 kishte ndonjë ndriçim të brendshëm apo edhe vegim.

Disa herë edhe e kam pyetur haptas për këtë përjetim, ngjarje, për thirrjen e dytë, apo si thoshte ajo “*thirrjen në thirrje*”. Ajo gjithnjë më thoshte të njejeten gjë: “*Isha e sigurt se ky ishte zëri i Zotit. Isha e sigurt se ai më thirrte mua. Porosia ishte e qartë: unë duhej ta lëja kuvendin për të ndihmuar të varfërit, të jetoja me ta dhe si ata. Ky ishte një urdhër, një detyrë, një domosdo. Unë kisha kuptuar se çfarë duhej të bëja, por nuk e dija se si*”⁵

Tash e dimë saktësisht se ajo pati atë ditë, por edhe më vonë, disa vegime dhe biseda intime me Jezui Krishtin. “*Ishte thirrja në thirrje... E kam ditur se ky ishte vullneti i tij dhe që duhesha doemos të shkoja pas Tij. Nuk kishte kurrfarë dyshimi se kjo do të ishte Vepra e tij... Zëri tashmë e thirrte qartas: “Eja, eja, më bart në kasollat e të varfërve. Eja dhe bëhu Drita ime!*”⁶

Për këtë i shkruajti arqipeshkvit Kalkutës Imzot Fernando PERIERA—s ndër të tjera kështu: “*Një ditë në Kungim plotësisht qartas e kam dëgjuar të njëjtin zë: “Dua murgesha indiane, flije të Dashurisë time, të cilat do të bëhen Maria*

⁵ Po aty, fq. 130.

⁶ Madre Teresa, Sii la mia luce, gli scritti più intimi della “Santa di Calcutta”, a cura di Brian Kolodiejchuk, M. C., Rizzoli, 2008, fq. 59.

dhe Marta... Thirrja jote është të dashurosh dhe të vuajsh dhe t'i shëlbosh shpirtat dhe me këtë do ta plotësosh dëshitrën e Zemrës time për ty. Kjo është thirrja jote...”⁷

Nëna Tereze shkruante kështu: “Qysh nga mosha pesë vjet e gjysmë, kur e kam pranuar për herë të parë (në Kungimin Shenj), dashuria për shpirtëra kishte depërtuar në brendinë time. Ajo ishte rritur gjatë viteve, deri sa nuk erdha në Indi me shpresë për të shpëtuar shumë shpirtëra. Gjatë këtyre tetmbëdhjetë viteve jam munduar të jetoja sipas dëshirave të Tija; Ndezem nga dashuria për Ta dashur si askush deri me sot...”⁸.

Arqipeshkvi Periera i përgjigjet : “Kemi nevojë shumë të lutemi si Ju, ashtu edhe unë, të mendojmë shumë, të jeni të kujdesshëm... Në korrik do të shkoj në Romë, dhe pa e përmendur enrin Tuaj, do t’ua paraqes rastin autoriteteve të atjeshme...”⁹.

Në Asansol filloi të ketë edhe pagjumësi dhe “adhurime” të natës. “Natë pas nate gjumi largohej dhe unë kaloja orë të tëra në dëshirë të gjallë për ardhjen e Tij. Kjo kishte filluar në Asansol në shkurt – e tani çdo natë zgjatë një apo dy orë, hetoj se është prej orës 23 deri në ora 1 pas mesnatës dhe kjo dëshirë depërton edhe në gjumë”.¹⁰

Shpirtërorit Celesti Van Exemit ndër të tjera i shkruante kështu: “Kam ardhur në Indi vetëm me shpresë që të shpetoja shumë shpirta dhe ta fitoja kurorën e martirizimit. Apostullimi që e kam zhvilluar gjatë gjithë këtyre viteve më ka ndihmuar shumë në zbatimin e kësaj dëshire. Dhe, ia, tani vitin e kaluar Ai erdhi me thirrje brenda thirrjes. Kjo thirrje

⁷ Po aty, fq. 59

⁸ Po aty, fq. 68-69.

⁹ Po aty, fq. 70-71.

¹⁰ Po aty, fq. 94.

*aq shumë është forcuar , është bërë aq e qartë në çdo meshë dhe Kungin të Shenjtë. Shpesh mrekullohem për rrugët e Tija... ”.*¹¹

Nëna Tereze për herë të parë në letrat e saja haptas shkruan për vegimet e saja në tri trajta: një mori e popullit, me fytyra të dhembshme, të varfër, të braktisur, që ishin të mbuluar me errësirë, klithnin: “*Eja, eja, na shpëto – na sjell tek Jezusi*”.¹² Vegimi i dytë ishte në shoqëri me të Lumen Mari Virgjër dhe ftesën e saj: “*Drejtoji tek Jezusi barte Jezusin tek ata*”.¹³ Vegimi i tretë ishte ky: prapë një mori e popullit, të mbuluar me errësirë, së bashku me Jezusin dhe Marinë, dhe zëri i vetë Jezu Krishtit: “*Unë t’u kam lutur. Ata t’u kanë lutur, dhe ajo – Nëna ime, të lutet*”. Dhe prapë pyetja: “*A do ta dëbosh këtë për mua?*”.¹⁴

Kjo gjendje ndërlihet me kushtin apo njetin e saj personal të vitit 1942, që e kishte pasë bërë me lejen e rrëfyesit, duke ia dhënë dhe premtuar Hyjit “*besën*” për plotësimin e vullnetit të tij kurdoherë. Mu për këtë ajo dëshironte sa më parë ta lëshonte bashkësinë rregulltare të Motrave të Loretos për ta ndjekur dhe plotësuar zërin e Zotit, apo “*thirrjen e dytë*”, e cila gjithnjë e trazonte dhe nuk e lente më të qetë.

1. Ekskluaziviteti apo shekullarizimi?

Nga letrat e Nënës Tereze me shpirtërorët e saj, me arqipeshkvën e Kalkutës, eproren provinciale të “Motrave të Loretos”, si dhe me Eproren Gjenerale të këtij rregulli, shihet

¹¹ Po aty, fq. 202.

¹² Po aty, fq. 110.

¹³ Po aty, fq. 111.

¹⁴ Po aty, fq. 111. Po aty, fq. 111; Krh. Berisha Nikë Anton, Jeta është vetë jeta e Zotit në ne, Sanctae Crucis, Prishtinë, 2007, fq. 109; Lexo: Berisha Nikë Anton, Errësira dhe vuajtja shpirtërore e Nënës Tereze përligjje e hirit të Hyjit dhe hyjnimit të saj, Sanctae Crucis, Prishtinë, 2008, fq. 25-29.

qartas se të gjithë e këshillonin për eksklaustrim apo dalje të përkohshme nga kuvendi, por që të mbetej e lidhur me Rregulline saj si dhe me Arqipeshkvin e Kalkutës. Mirëpo ajo ishte e vendosur, e sigurt, se duhej braktisur tërësisht bashkësinë e Motrave të Loretos, për të themeluar Regullin e ri.

Ja përvoja e saj e re pas largimit nga kuvendi i motrave: *“Sot e kam mësuar një mësim të mirë – që varfëria për të varfër është shpesh tejet e rëndë... Kam ecur gjithnjë deri sa nuk kam pasur dhembje në duar dhe në këmbë. Kam menduar se edhe atyre duhet t’iu dhembnin trupi dhe shpirti deri sa kërkojnë shtëpi – ushqim – ndihmë. Pastaj më erdhi tundimi – në mend më erdhen shtëpiat e bukura të Loretos, gjërat e bukura dhe komode...”*¹⁵

Mua duke më treguar për natën e parë nën qiellin e hapur më tha se ishte lutur kështu: *“O Zot, nëse nuk mund të bëj asgjë për këta njerëz të njerë, atëherë më jep seë paku fuqi që të vdes në mesin e tyre për ta dëshmuar dashurinë Tënde!”*¹⁶

Në këtë lutje të shkurtë dhe përmbajtësore shprehet, paralajmërohet zbulohet dhe dhurohet e tëra Nëna Tereze, sepse ajo nuk kërkon prej Zotit ndonjë mrekulli, punë të madhe dhe të suksesshme, asgjë, por fuqinë e fesë për të qenë dhe jetuar në mesin e të mjerëve, me një qëllim të vetëm: *për ta dëshmuar Dashurinë e Zotit pikërisht atyre që i ka “shkelur” jeta, varfëria, sëmundja, gërbula...*

Leja prej Romës erdhi më 7 shtator 1950. Në prill të vitit 1952 ajo i shkruante Imzot Perier-it kështu: *“Dua të bëhem shenjtëreshë, për ta shuar etjen e Jezusit për dashuri ndaj shpirtave. E kam edhe një dëshirë të madhe – t’ia dhuroj Kishës Nënë një numër të madh dhe të shenjtë të motrave*

¹⁵ Po aty, fq. 141.

¹⁶ Don Lush Gjergji, Nga shënimet e mia.

nga Rregulli ynë. Vetëm për këto dy gjëra lutem dhe vuaj...”.¹⁷

Katër ditë pas dhënies së lejes nga ana e arqipeshkvit F. Perier Nëna Tereze i shkruante kështu eprores gjenerale, Nënës Gertrude: “Me 6 janar 1948 erdhi për të kremtuar meshën (mendohet në Imzot F. P. vr. ime) dhe pas meshës më tha: “Mund të filloni”... Dua ta lëshoj Loreton sa më parë të jetë e mundshme, posa Kongregata e Shenjtë të më sigurojë asgjësimin e kushteve rregulltare dhe indultin e shekullarizimit... Kam paraparë vuajtje të shumta dhe vështirësi që do të më sjellë jeta e tillë – mirëpo verbërisht shpresoj në Zotin dhe e di që Ai nuk do të më braktisë, edhe nëse do të gaboja...”.¹⁸

Braktisja e Motrave të Loretos ishte për Nënë Tereze një vuajtje dhe dhembje tejet e madhe, edhe më e madhe se ndarja nga familja dhe Shkupi. Ja dëshmia e saj: “Në Institutin e Motrave të Loretos kam hyr në tetor të vitit 1928. Kushtet e para të përkohshme i kam dhënë në vitin 1931, ndërsa të përgjeshmet në vitin 1937. Prej vitit 1937 punoj në Indi (në Bengali). Jam shqiptare, mirëpo kam jetuar me prindërit e mi në Jugosllavi... Gjatë këtyre viteve të jetës rregulltare kam qenë shumë e lumtur si antare e Istitutit të LMV (Lumes Mari Virgjër), aq sa edhe vetë mendimi që të largohesha ma therrte zemrën. Porse Hyji i gjithëpushtetshëm më thërret në një jetë të tillë nuk e di përse, por dua tërësisht t’i përkas Atij – me çdo çmim ta kryejë vullnetin e tij... Dua rreth vetes t’i mbledh shpirtrat tjerë, që do të bënin të njëjten gjë për t’u shërbyer të të varfërve ndër më të varfër, më të braktisurit, më të përbuzurit. Miliona të tillë jetojnë nëpër qytete dhe fshatra

¹⁷ Madre Teresa, Sii la mia luce, vep. e cit. fq. 151.

¹⁸ Po aty, fq. 114-115.

*të Indisë duke mos e njohur Zotin dhe Jezusin, në mëkate të tmerrshme. Do t'i afrojmë Krishtit dhe Krishtin atyre”.*¹⁹

Më 17 gusht 1948 Nëna Tereze e veshi sarin e bardhë dhe e filloi jetën e re të Misionares së Dashurisë. Kuptohet se hapat e parë nuk ishin aspak të lehtë. Kur arriti në Patna për të mësuar sadopak shërbimin ndaj të sëmurëve, në një fletore të shënimeve kishte shkruar kështu: *“O Jezu, dashuria e vetme e zemrës time, dua të vuaj atë që vuaj dhe çdo gjë që Ti do të lejosh të vuaj nga dashuria e pastër ndaj Teje, e jo për merita që do të mund të fitoja, apo për dhurata që më ke premtuar, por vetëm për të kënaqur Ty, për të lavdëruar Ty, për të bekuar Ty si në gëzim ashtu edhe në pikëllim”.*²⁰

Ndarjen nga Motrat e Loretos e kishte përjetuar rëndë edhe mbarë bashkësia, sidomos shoqja e saj nga Shkupi, motra Gabriella Zadrina, e cila iu kishte bashkangjitur Motrave të Loretos qysh në vitin 1932 dhe kishte punuar në arsimim, si edhe Nëna Tereze, si profesreshë e shquar dhe e dalluar.²¹

Ajo me dhembje dhe me dashuri i shkruante Nënës Tereze kështu: *“Oh, po ta dishe si e kam lexuar letrën tënde, tërë ditën kam qarë, edhe pse e kuptoj se është vullnesa e Zotit... Dije se të gjitha motrat flasin mirë për ty; asnjëra nuk e ka thënë asnjë fjalë kundër teje...Ai, i Lavdishmi, dëshiron ta zbulojë nëpërmjet teje vullnetin e tij – Qofshë bekuar Ti që Zoti të zgjodhi për këtë flijim të madh, sepse prej Tij gjithmonë ke pranuar kryqin, mu për këtë Zoti ta ka caktuar këtë rrugë të rëndë; Ai e di se ti mund ta bartësh Kryqin e tij...”.*²²

¹⁹ Po aty, fq. 123-124.

²⁰ Po aty, fq. 132.

²¹ Më gjerësisht lexo: DRITA, viti I /1970/, nr. 4-5, fq. 5.

²² Madre Teresa, Sii la mia luce, vep. e cit. fq. 133.

Pas largimit nga Motrat e Loretos dhe takimit, edhe më mirë të themi “*ndeshjes*” me njerimin e Kalkutës, Nëna Tereze shkruante kështu: “*O Zoti im, me zgjidhjen time të lirë, nga dashuria për Ty – dua të mbes dhe ta bëjë vullnetin Tënd të shenjtë për Ty... Nuk i lejova vetes as një pikë loti... Kjo është nata e errët e lindjes së Rregullit. O Zoti im, më jep tani guxim, në këtë çast – që t’i mbes besnike Ftesësë tënde*”.²³

Don Lush GJERGJI

Gonxhe Bojaxhiu, motra Tereze dhe Nëna Tereze

Tri periudha jetësore, Gonxhe Bojaxhiu, motra Tereze dhe Nëna Tereze, kanë veçorit dhe tiparet dalluese në jetën dhe veprën esaj. E përbashkëta e çdo kohe, rrethane dhe periudhe është: feja –kërkim, shpresa – veprim dhe dashuria – flijim dhe dhurim. Pra, kërkimi, veprimi dhe flijimi – dhurimi, e “de-tyruan” atë që vazhdimisht të ishte e hapur ndaj Zotit – Dashuri dhe Vëllaut – motrës – Njeri, edhe në kushte të pamundshme siç ishte Kalkuta e atëhershme, Bengalia, India, bota. Sivjet, në 105 vjetorin e lindjes së Gonxhe Bojaxhiut, në 65 vjetorin e themelimit të “Misionareve të Dashurisë” dhe tre vjetorin e shpalljes së 5 shtatorit nga OKB-ja “Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë”, do të shqyrtojmë rrethanat e pavolitshme politike, shoqërore, fetare, kishtarë, në të cilat ajo i kishte të gjithë kundër saj, pothuaj tërësisht ishte e vetmuar. Megjithatë, ia doli, i bindi të gjithë, me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë, dhe ndërmori të “pamundshmen” për

²³ Po aty, fq. 141.

të varfëritë ndër më të varfër, të braktisurit, të gërbulurit, njerëzit në buzë të vdekjes, për të gjithë, duke dëshmuar kë-shtu që kush beson dhe dashuron, gjithnjë vepron dhe jeton. Ja, e tillë ishte e Lumja Nëna jonë Tereze.

Dr. Don LUSH GJERGJI, prift katolik shqiptar i Ipeshkëvisë së Kosovës, i lindur më 21 mars 1949 në Stubëll të Epërme. Shkollën fillore, katër vitet e para, i kreu në vendlindje, vitin e pestë në Viti, tri vitet e fundit në Zhegër. Gjinnazin klasik në Dubrovnik (1963–1967), vitin e parë të filozofisë në Split (1967–1968), ndërsa vitet tjera dhe magjistrimin në filozofi, diplomimin në teologji po ashtu në Romë në Universitetin Papnor “Urbaniana” (1968–1973).

Paralelisht në Universitetin shtetëror të Romës «La Sapienza» ka studiuar dhe doktoruar psikologjinë në vitin 1975 me temën “La donna albanese” (Gruaja shqiptare), që është botuar edhe në gjuhën shqipe “Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri”.

Vite me radhë redaktor dhe kryeredaktor i revistës fetaro-kulturore “DRITA”, si dhe i shtëpisë botuese katolike “DRITA” me seli në Ferizaj, më vonë në Prizren, tani në Prishtinë. Ka shërbyer në këto famulli: në Ferizaj (1975–1993), në Binçë (1993–2006), në Prizren (2007–2009). Aktualisht është Vikar Gjeneral i Ipeshkvisë së Kosovës me seli në Prishtinë.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtar i Gazetarëve dhe Publicistëve Katolik të Evropës dhe anëtar i Akademisë Evropiane.

Deri tash ka botuar më se 60 vepra në gjuhë të ndryshme, sidomos 15 tituj kushtuar jetës dhe veprës së Nënës Tereze që janë përkthyer në shumë gjuhë.

SKENDER ASANI

Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

PRONËSIA E SHTËPISË SË GONXHE BOJAXHIUT (NËNË TEREZËS) – DËSHMI PËR SHQIPTARËSINË E SHESHIT TË SHKUPIT (DOKUMENT)

Emri i nobelistes shqiptare me përmasa botërore, Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza, lidhet ngushtë me qytetin e Shkupit, aty ku ajo lindi, u rrit dhe mori hapat e parë për të qenë në shërbim të njerëzimit. Për fëmijërinë e saj në qytetin e Shkupit ka shumë pak informacione, dhe këtë mungesë shumë mirë e kanë (keq)shfrytëzuar disa qarqe që kanë tentuar për t’ia ndryshuar edhe identitetin e saj etnik. Për pjesën e rinisë së Gonxhe Bojaxhiut më së miri do të shprehet biografi i saj personal, Don Lush Gjergji, i cili shkruan: “Çdo gjë, apo gati çdo gjë dihet për Nënë Tereze, por pothuajse asgjë për Gonxhe Bojaxhiun, ndonëse është fare e qartë se nuk ka Nënë Tereze pa Gonxhe Bojaxhiun”.²⁴

Që nga viti 2006 institucionet shtetërore filluan ta realizojnë projektin “Shkupi 2014“, i cili kishte për synim të zhdukte kujtesën historike për sheshin e Shkupit dhe në shënjestër ishte asgjësimi i themeleve të shtëpisë ku kishte lindur Gonxhe Bojaxhiu. Qëllimi kryesor ishte të mënjanohej elementi i fundit shqiptar në këtë shesh. Jo rastësisht, në fillim aty u tentua të ndërtohet Kisha “Shën Elena dhe

²⁴ Don Lush Gjergji, *Nëna e Dashurisë*, Prizren, 2010, 35.

Konstantini“, dhe tash së fundmi parashihet të ndërtohet edhe një hotel. Edhe ndërtimi i shtëpisë memoriale Nënë Tereza ishte në shërbim të dislokimit në një vend tjetër me synim për të realizuar projektin e paraparë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, dhe për të zhdukur kujtesën historike se në këtë shesh asnjëherë nuk ka ekzistuar Lagjja e Katolikëve Shqiptarë dhe shtëpia e Gonxhe Bojaxhiut.

Duke hulumtuar në Arkivin e Qytetit të Shkupit, konkretisht fondin “Градско поглаварство“, hasa në disa dokumente gjyqësore ku shihej se Nikollë Bojaxhiu, shtëpinë e cila gjendej në sheshin e sotëm të Shkupit, para vdekjes ia kishte lënë në pronësi bijës së tij, Gonxhe Bojaxhiut. Kur ndërroi jetë Nikolla, Gonxhja ishte në moshën nëntëvjeçare. Këto dokumente korrespondojnë me vitin 1928, kur ajo mori vendimin të niset në misionin të shenjtë. Sipas këtyre dokumenteve kuptojmë se ajo për shkaqe të përcaktimit të saj jetësor, kishte marrë vendim që të shlyhej nga çdo pasuri e këtushme që ishte në emër të saj, dhe pronësinë e shtëpisë e hedh në emër të së ëmës, Drane Bojaxhiu.

Ky dokument është shumë i rëndësishëm për qenësinë e katolikëve shqiptarë në Shkup, dhe veçanërisht për trashëgiminë kulturore e historike të familjes Bojaxhiu. Nëna e mbarë botës – Nënë Tereza, pa dyshim që meriton më shumë kujdes nga të gjithë ne, meqë shtëpia e saj që ndodhej dikur në sheshin e Shkupit, është një dëshmi e padiskutueshme për shqiptarësinë e këtij sheshi dhe gjithë Shkupit.

42/112-118

Суду свјетитиме паже Скотне

По предмету масе тж.
Николу Бајанџевића тж. из Скотне
Старатајски судија овога суда пре-
поручује поше Суду, да председном
једно правно саветно лице за свара-
тена имања мањопитне Гонци кте-
ри пок. Николу Бајанџевића (у см.
§188. зак. о стар.) како бих овај сва-
рајен имања могао дати одобрење
за издају масене куће у мањо ма-
нопитне Гонце, пошто је мањо
сварајоз масе тж. Николу Бајанџе-
вића удовица Еронца Бајанџевић
Законитересована у овој маси, јер
јој је мањопитни једини нестудник
Мазар мањопитно заосидавшишину
пок. Бајанџевића
је диније отаџина ајак се удови Еронца
Бајанџевић тж. тж. Кошачија д.т.

Бр 38822.

Старатај. Судиз

10. децембра 1900.

Скотне
М. Бр. 28.



Н. Бајанџевић

Gjyqi Komunal i Shkupit

Lidhur me subjektin e të ndjerit Nikolla Bojaxhieviq, ish-qytetar i Shkupit.

Gjykatësi për trashëgimi i këtij gjyqi i rekomandon gjyqit tonë, që të propozohet një person juridik si kujdestar i pronës së Gonxhes, vajza e Nikolla Bojaxhieviq (sipas nenit 158, ligji i trashëgimisë), në mënyrë që kujdestari të mund të japë dakordim për shitjen e shtëpisë, në vend të Gonxhes (e mitur). Prona kryesore i është huazuar Drania Bojaxhieviqit nga Nikola Bojaxhieviqi. Lidhur me këtë pronë, i vetmi trashëgimtar i rritur, Lazari, i donoi trashëgiminë e tij të ndjerit Bojaxhieviq.

Nr.38822

10.12.1928

Gjykatësi për trashëgimi, Shkup

Скопље Municipality Court of Skopje

Regarding the subject of the deceased Nikola Bojadzievic, ex-citizen of Skopje.

The custodial judge of this court recommends to our court, to be proposed a legal entity (body) as a trustee of Gonxhe's property, daughter of Nikola Bojadzievic (regarding article 158, custody law), so the trustee could approve the sale of the house instead of Gonxhe as minor (underage). The main property was leased from Nikola Bojadzievic to Drania Bojadzievic.

Regarding this property, the only adult heritor Lazar donated his heritage to the deceased Bojadziev.

Nr.38822

10th of December, 1928

Custody Judge, Skopje

PROF. DR. NEBI DERVISHI

Profesor i historisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës

**“NËNË TEREZA – NOBELISTJA
SHQIPTARE NGA SHKUPI”
(ME RASTIN E 105 VJETORIT
TË LINDJES – 26 GUSHT 1910 – 2015)**

Në historinë e njerëzimit ka shumë njerëz që zënë vend të merituar në kujtesën e brezave. Në radhën e tyre hyn edhe humanistja e shquar shqiptare, Nënë Tereze. Kur ishte e vogël, njerëzit e njihnin me emrin Gonxhe Bojaxhiu. Gonxhja jetoi në shek. XX, kohë e realizimeve të mëdha tekniko-shkencore në historinë e njerëzimit, shpikjes së atomit, zhvillimit të letësisë, muzikës botërore dhe arkitekturës.



Nënë Tereza nuk u shqua në këto fusha, ajo iu kushtua një tjetër punë (misioni), në shikim të parë e vogël, por që pas shumë viteve, befasoi mbarë njerëzimin. Ajo u morr me varfërinë, me fatin e njerëzve të pafund që vuanin prej saj. Bota ka vuajtur prej shekujsh urinë, mjerimin e varfërinë. Shumë luftëra janë bërë për një jetë më të mirë. Me të varfërit ishte edhe Nënë Tereza, e cila u ngrit si misionare katolike të zbuste këtë plagë, të ndihmonte dhe të mbronte njerëzit e zakonshëm, jo duke nxitur urrejtje dhe dhunë, por nëpërmjet dashurisë dhe mirëkuptimit për njëri tjetrin. Në këtë mënyrë Nënë Tereza u bë simbol i kësaj lufte dhe bëri për vete botën mbarë.

E lumja Nënë Tereza shpesh thoshte: “Shenjtërimi nuk është një luks vetëm i disa njerëzve të paktë, por një detyrim i thjeshtë për të gjithë ne”. Më pak se dy vjet pas vdekjes së saj, për shkak të përhapjes së famës së shenjtërisë dhe hireve të nxjerra me ndërmjetësimin e saj Papa Gjon Pali II, lejoi të hapej çështja e kanonizimit. Më 20 dhjetor 2002 miratoi dekretin mbi virtytet dhe mrekullitë e bëra me ndërmjetësimin e saj. Më vitin 2003 u bënë ritualet e beatifikimit, si fazë e dytë që i paraprinë shenjtërimit. Më 19 tetor 2003, shenjtëria e tij, Papa Gjon Pali II, shpalli të Lume misionaren e madhe shqiptare, Gonxhe Anjeza Bojaxhiu, e njohur në botë si Nënë Tereza. Në sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan, ishin tubuar rreth 400 mijë pelegrinë nga e tërë bota. Gonxhe Bojaxhiu, e njohur si Nënë Tereza e Kalkutës, ka lindur në Shkup, më 26 gusht 1910, sot plot 105 vjet më parë. Gonxhja, e bija e vogël e Kolë dhe Dranë Bojaxhiut, u lind për të shkruar historinë më të re të shek. XX në aspektin e vetësakrificës dhe devotshmërisë që njeh njerëzimi. Ajo dëshmoi fuqinë e miqësisë vëllazërore, duke nxitur kështu

zhvillimin njerëzor dhe shoqëror. Jeta e saj ishte një kushtim ndaj të sëmurëve dhe të varfërve.

“Me gjak jam shqiptare, me nënshtetësi indiane. Përsa i përket besimit jam murgeshë katolike. Sipas thirrjes i përkas botës. Por zemra ime i përket plotësisht zemrës së Krishtit”.

Janë këto fjalët e gruas me shtat të imët, që nuk rreshti asnjëherë duke ndihmuar të varfërit, por që nuk harroi asnjëherë origjinën e saj.

Në moshën 18 vjeçare, më 26 shtator vitin 1928, e shtyrë nga dëshira për t’u bërë misionare, Nëna Terezë veshi për herë të parë sarinë e bardhë me shirita të kaltër, që u bë simbol i gruas që ndihmoi ata që ishin më në nevojë në mesin e nevojtarëve. Ka qenë 21 dhjetori i vitit 1948 kur shkeli për herë të parë në lagjet e të varfërve në Kalkuta, ku vizitoi familjet, u lau plagët të sëmurëve dhe atyre që vdisnin në rrugë.

Që nga ajo kohë ajo u shërbeu atyre që janë “më të braktisur, të padashur, të papërkujdesur”, – siç thoshte ajo. Bota moderne në anën tjetër, për punën dhe veprimtarinë e saj e shpërbelu me mbi 130 dekorata, në mesin e tyre në 19 dhjetor 1979 edhe me çmimin Nobel për Paqe, në Oslo.

Për Gonxhe Bojaxhiun, alias Nënë Terezen në mjedisin tonë dihej pak dhe pak flitej. Se kjo vjază shqiptare e lindur në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, Shkup, nga prindërit Kolë e Dranë Bojaxhiu, familje me tradita atdhetare, u arratis në botë e nëpërmjet Zagrebit dhe Irlandës arriti në Indi ku u bë profesoreshë e gjeografisë (afër 20 vjet) dhe drejtoreshë e shkollës “S. Mary’s”, më pastaj edhe murgeshë, duke themeluar rendin humanitar “Misionet e Mëshirës”, dinin vetëm ata që lexonin ndonjë vepër kushtuar humanistes më të madhe të shekullit XX. Për të dinin edhe ata që rastësisht i

çonte puna të përmendin se kjo humaniste ka preardhjen shqiptare. Dhe vetëm kaq!

Për Nënë Terezën më gjëresisht opinion shqiptar kuptoi kur në vitin 1979, në Oslo, kjo Nënë e Botës, siç e quajtnë atëbotë u shpërble me çmimin e lartë “Nobel” për paqe. Dhe, nuk vonoi shumë, ballëhapur e krenarë të gjithë rrahëm gjoks se pikërisht kjo shqiptare nga Shkupi i Dardanisë, barti flamarin anëkënd botës për veprimtarinë e saj humane kushtuar të braktisurve, të vobektëve, të sëmurëve, të pastrehurve, të leckosurve, duke themeluar qendrat humane të rendit “Motrat e mëshirës” në shumë kënde të botës.

Më kujtohet mirë, para 36 vitesh (i kisha 26 vjetë dhe isha prof. i historisë në Gjinnazin e Strugës), shtypi i atëhershëm shkroi shumë pak për këtë ngjarje me peshë të madhe, edhe në ato raste kur shënohej për ndarjen e çmimit “Nobel”, Nënë Terezës. Asnjë gazetë maqedonase nuk bëri shënimin e nevojshëm se ajo ishte me preardhje shqiptare, nga Shkupi, nga prindërit Kolë e Dranë Bojaxhiu. Kurrkund nuk u shënuar se ajo kishte edhe vëllain Lazrin dhe motrën Agëje dhe se kjo familje shqiptare e Shkupit ishte një ndër më të vjetrat dhe më të nderuarat e qytetit buzë Vardarit.

Më kujtohet se u bënë përpjekje edhe për preardhjen e saj joshqiptare! Madje u tha se ajo rrjedh nga një familje vllehe duke ia pagëzuar të atin me emrin Nikolla. Po e vërteta nuk duron shtrembërime. E vërteta ngadhënjën. Sot emri i Nënë Terezës qëndron në piedestalin më të lartë të personaliteteve të shquara të shek. XX.

Mediat e shkruara në Maqedoni, kushtuar Gonxhe K. Bojaxhiut ose Nënë Terezës së Kalkutës kanë një traditë të hershme. Revista e katolikëve të Sërbisë së Jugut në Mbreterinë Jugosllave e botuar në nëntor – dhjetor 1932, në

Shkup, Nr. 82, në gjuhën serbo – kroate sjellë një shkrim tepër interesant për misionaret nga Shkupi.

“Në këto misionare, vlen të përmenden tri vajza shqiptare: misionaren tanimë të njohur, Gonxhen, e pagëzuar me emrin e urdhërit fetar Terezë dhe Nasta Mihilit, e cila e shoqëronte deri në Bengal. Vajza e tretë është Ana, e cila mbeti në Jugosllavi, por që vajti shumë larg prej prindërve të saj për t’u bërë murgeshë...”

Në gushtin e vitit 2010, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, në kuadër të shënimit të 100 vjetorit Jubilar të lindjes së shenjtores “Nënë Terezë” – “Një shekull dashuri”, punimin e Revistës “Blagoviest” të 1932 e përktheu në tri gjuhë (shqip, maqedonishtë e anglisht) dhe e botoi në një broshurë të veçantë, këtu në Shkup.

Në harkun kohor 1990–2015, këtu në Shkup, mediat e shkruara dhe ato elektronike në të dy gjuhët, shqip e maqedonisht zhvillojnë një “luftë” pa kompromis rreth figurës së Nënë Terezës – e cila është simbol i së mirës, dashurisë, humanizimit dhe simbol i nënave shqiptare.

Në fushatën tanimë që ka hedhur shtat kundër vlerave dhe trashëgimisë kulturore e historike shqiptare në Maqedoni, përpjekja për zhveshjen nga identiteti shqiptar të Nënës Tereze, paraqet kulmin absurd (të pakuptimtë) të kësaj fushate.

Në fillim ia ndërruan mbiemrin, duke shënuar jo me Bojaxhiu, por Bojaxhieviq. Është interesante që Qeveria kroate pas vitit 1992, ia “dhuroi” Nënës Tereze pasaportën kroate, pra, ende kishte njerëz që vepronin në atë drejtim me një prapavijë politike për ta përvetësuar Nënë Tereze, duke u bazuar në atë se Nënë Tereze “dinte më mirë kroatishten se shqipen”.

Më vonë edhe serbët tentuan që ta paraqesin me prejardhje serbe Nënë Tereze, por nuk hynë më thellë, sepse nuk kishin kurrfarë baze.

Pastaj iu rrekën punës qarqet maqedonase, me prapavijën e tyre politike për “përvetësimin” e saj. Kohëve të fundit kësaj përpjekje meskine iu bashkangjiten edhe vllahët, ku flamurin e mban Aurel Plasari –shkrimtar dhe studiues nga Tirana. Meqë qarqet maqedonase nuk ia dolën, u shpik një metodë e re për ta kontestuar preardhjen e saj pse ishte shqiptare dhe natyrisht duke u munduar që nëpërmjet kësaj figure kaq të madhe të përmirësojnë edhe imazhin e tyre.

Një fushatë absurde vazhdon gjithë këto vite, si p.sh. Në Enciklopedinë e Përgjithshme maqedonase nga Shtëpia Botuese “Mi-an”, nën redaktimin e Jovan Pavloskit, botuar në Shkup, 2006, në 4 vëllime, në zërin kushtuar Nënë Terezës, në faqen 957 shënohet se është “e përkatësisë vllahë”.

Edhe në Enciklopedinë maqedonase e botuar më 2009, hartuar nga albanofobi Bllazhe Ristevski, në faqen 187, në zërin kushtuar Gonxha – Agneza Nikolova Bojaxhiu, nga autori Simo Mlladenoski, bëhen përpjekje për të mjegulluar origjinën e Nënë Terezës – e cila është nder, bekim dhe krenari e kombit tonë shqiptar.

Tërë këto vite, nga 1990–2015, përpjekjet e mediave të shkruara dhe elektronike në gjuhën maqedonase, si: “Dnevnik”, “Vreme”, “Veçer”, “Nova Makedonija”, “Utrinski Vjesnik”, TVM –1, TV – Sitell”, Tv – A1, TV – Kanal 5, TV – Telma, etj janë në drejtim të kontestimit të prejardhjes etnike të saj. Madje shoqatave të ndryshme maqedonase joqeveritare dhe “qytetare”, kundrejt origjinës së Nënë Terezës u merrret goja dhe u shteret lapsi kur duhet përmendur preardhja e kësaj bije të madhe të kombit shqiptar.

Përvetësimi dhe falsifikimi i historisë në rastin e Nënës Tereze dhe poashtu edhe në historinë dhe trashëgiminë kulturore shqiptare mesjetare dhe të asaj në përgjithësi, tërë këto vite nga 1945 është bërë dhe po bëhet me qëllim të vazhdimsisë historike dhe të autoktonisë shqiptare në trevat lindore. Shtetësia e përvetësimit dhe falsifikimit të historisë shqiptare i solli, pra, në pikën ku ata lehtë tentojnë të falsifikojnë edhe atë më të qartën – identitetin e Nënës Terezë. Por, mendësia politike dhe e një pjese të elitës intelektuale maqedonase funksionon sipas metodave primitiviste. Së këndejmi, inagurimi i shtëpisë së Nënës Terezë (Gonxhe Bojaxhiu) sipas shijes maqedonase në një vend tjetër, xhirimi i një filmi me gënjeshtër “Brigjet e Mallit” (Dokumentar) të Stojan Traçevskit në vitin 2008, i cili ishte kryetar i shoqatës “Skopjankata Majka Tereza” (Shkupjanja Nënë Tereza), etj, duke i shpërfillur shqiptarët në Maqedoni, me të drejtë ka shkaktuar polemika dhe reagime të mëdha nga intelektualët dhe shoqatat shqiptare këtu në Maqedoni, të cilët janë të bindur pa përjashtim, se këtë e bëjnë vetëm ata që ndjejnë mungesën e identitetit dhe i futen zanatit të vjedhjes, përvetësimit dhe falsifikimit.

Mediat e shkruara dhe vizuale në Maqedoni në gjuhën shqipe si: “Flaka”, “Lajmi”, “Koha”, Fakti”, “24 orë”, “Arena”, “Koha e Re”, “Zhurnal”, “Lobi”, TVM– 2”, “TV Kaltrina”, “TV– Era”, “Art – Kanali” “TV – Koha”, etj. , tërë këto vite e patën shumë të vështirë të veprojnë në njërin anë, po në anën tjetër e patën një përparësi sepse “Nënë Terezë diti me mëshirën dhe bamirësinë e saj të jehojë anekënd botës për t’u dalur zot jo vetëm të varfërve, por edhe të dëshmojë se populli i lashtë shqiptar pati në gjirin e vet dhe diti t’i japë botës një shenjtore që përhapë anekënd botës mesazhin e

dashurisë dhe mëshirës. Nëse Ajo me veprën e saj e “shenjtëroi” edhe popullin shqiptar si bijë e tij, me siguri se edhe populli shqiptar nuk do të lejojë që askush që ta nëpërkëmbë identitetin dhe origjinën e saj.

Njerëzit e rrallë kanë diçka të veçantë në gjenin e vet, andaj edhe me veprimet e tyre rrezatojnë në të mirë të njerëzimit për së gjalli dhe në të mirë të njerëzimit si shembëllesë pas vdekjes.

Ata, mbi të gjitha, mu për madhështinë që ua dhuroi Zoti, janë frymëzim edhe për të gjitha gjinitë e arteve. Këto fjalë mund të mbështeten bindshëm në personalitetin e shenjtore sonë, Gonxhe Bojaxhiut alias Nëna Tereze. Ajo dhe bëmat e saj hynore u bënë frymëzim për poetët e shumtë, shkrimtarët, studiuesit, artistët, skulptorët e piktorët.

Në vitet '90 të shekullit të kaluar dhe në këto dy dekada të para të këtij shekulli këtu në Maqedoni, për Nënë Tereze janë krijuar vepra të vogla a të mëdha në lloje e në gjini të ndryshme arti dhe ku gjetën veten shumë poetë, publicistë, piktorë, skulptorë e studiues të tjerë, të cilat vepra, shtypi i kohës në gjuhën shqipe i ka publikuar dhe përshkruar gjërësisht, si p.sh.: Kadrije Zejnullahu, “Nëna ime – Nëna Tereze” (2008); Bashkim Kozelli “Nënë Tereza – ishte Gonxhe” (2006); Nuhi Vinca “Të duem laudamus” (Lirikë për Nënë Terezën)” (2003); Dr. Lutfi Turkeshi, Eugen Shehu, Puntorije Muça – Ziba; Anton Nikë Berisha “Nëna Tereze në tri shpalime” (2010); Pjetër Përgjoka “Nëna Tereze – frymëzimi për jetën dhe veprën” (2005); Don Pren Kola “Nënë Tereze – në fotografi dhe fjalë”, etj, si dhe Don Dr. Lush Gjergji” “Nona Jonë Tereze” (1990) dhe mbi dhjetë libra të tjera kushtuar nobelistëve shqiptarë. Mandej në fushën e skulpturës Xhelil Rufati; në pikturë Prof. Miftar Memeti, në

fushën e muzikës Mr. Selami Kolonja, e shumë të tjerë. Për figurën e Nënës Tereze, shqiptarja me zemër të madhe, me të cilën fillon dashuria për njerëzimin, flitet dhe shkruhet gati në tërë gjuhët e botës këto vite, si me rastin e marrjes së çmimit Nobel për Paqë (1979), në përvjetorin e vdekjes apo në lumturimin e saj.

Edhe në qytetin e lindjes, këtu në Shkup janë zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore.

Në vitin 2004, në qytetin e Strugës, Shoqata Bëmirëse Humanitare “Nënë Terezë” në qendër të kasabasë ka ngritur shtatoren e shenjtore shqiptare. Edhe në qytetin e lindjes së saj është ngritur përmendore ku shkruhet me germa cirilike “Skopjankata Majka Tereza” (Shkupjanja Nëna Tereze) dhe anëve të bustit qëndrojnë emrat e autorëve që e kanë punuar atë. Në kullën feudale është improvizuar një dhomë e cila është emëruar si dhoma e Nënë Terezës, edhe pse ajo kullë nuk ka lidhje me shtëpinë e saj.

Në qendër të qytetit, aty ku ka lindur Nëna Tereze më 26 apo 27 gusht 1910, në rrugën “Kiçina”, Nr. 13, afër qendrës së sotme tregtare, aty ku me të vërtetë ka qenë njëra nga shtëpitë e Kolë Bojaxhiut, Shoqata “Skopjankata Majka Tereza”, e ndihmuar financiarisht nga Ministria e Kulturës ka vënë një pllakë përkujtimore ku shkruhet në njëjërën anë maqedonisht “Ovde se naogjall kuqata na nobeliskata Ganxha Bojaxhiu” (Këtu ka qenë shtëpia e nobelistes Gonxhe Bojaxhiu) dhe në anën tjetër është skalitur teksti në gjuhën angleze. Këtë pllakë përkujtimore, huliganët maqedonas, këto vite, disa herë e përdhosën dhe e thyen. Nga organet kompetente zyrtare asnjëherë nuk u prononcuan deri ku janë hetimet mbi këto akte vandale. Shqiptarët dhe shoqatat joqeveritare shqiptare kanë protestuar zëshëm dhe këto

protesta mediat e shkruara dhe vizuale në gjuhën shqipe gjërisht i kanë përcjellur. Dhe qëllimi i këtij vandalizmi në fillim të vitit 2015 doli në sipërfaqe, sepse Qeveria e Republikës së Maqedonisë s'heqë dorë nga zhdukja e gjurmëve – sepse dëshiron të ndërtojë hotel mbi themelet e Shtëpisë së Nënë Terezës. Pas dislokimit të shtëpisë së saj në një vend që nuk ka qenë asnjëherë, mbi themelet e shtëpisë së Bojaxhinjve, së pari u parapa të ndërtohet kisha “Shën Elena dhe Konstantini”, më pasë shkallët spanjolle dhe tani së fundi iu dha dritë jeshile ndërtimit të hotelit të stilit barok.

Pra, qendrës së Shkupit do t'i shtohet edhe një hotel i stilit barok, i cili do të ndërtohet tek shtëpia ku u lind dhe u rrit Gonxhe Bojaxhiu, e njohur në tërë botën si Nënë Tereza, aty ku së pari ishte paraparë që të ndërtohet kisha “Shën Elena dhe Konstantini”; Qyteti i Shkupit, me urdhër të Qeverisë së Maqedonisë, më 19 shkurt 2015, e liroi investitorin “Amadeus Development DOOEL” nga 50-të përqindshi për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e “Dy objekteve komerciale për qëllime afariste me hotel, sipas Planit Detal Urbanistik Ringu i Vogël”. Sipas planit objekti do të jetë i lartë 16m, ose ndërtesë trikatëshe, plus katin përdhësë. Investitori ka blerë tokë për 1.6 milion euro në vitin 2013. Sektori civil shqiptar edhe me këtë rast ngriti zërin, por qeveria me avazin e vjetër nuk shqetësohet, sepse i ka vazalët në qeveri të cilët janë të interesuar për tenderët e tyre dhe s'çajjnë kokën për problemet kombëtare.

“Nënë Tereza është kuotë dhe vlerë globale, po mbi të gjitha është kuotë me vlerë shqiptare, bijë e gjakut dhe e kombit tonë, që po zhvishet sot për lule të marres nga kuotat identitare me qëllim të shpërlarjes së kujtesës sonë historike, me qëllim satanizmin dhe shuarjen sonë në këste si pjesë e

kombit shqiptar. Shoqëria civile dhe intelektualët shqiptarë kanë një mesazh të qartë se një etni apo komb e mbetur pa kuotat e saj është e denjë për nëpërkëmbje dhe për hyzmeqari të përjetshme, është rajë, është një hiç“.

Më 26 gusht 2015, mbushen plotë 105 vjet nga lindja e Nënës Tereze. Rrjeti global televizivë CNN, këto ditë, si edhe me rastin e 100 vjetorit, i kushtoi një reportazh ekskluziv kësaj figureje të ndritshme të shek. XX, duke theksuar se “nga ana e Maqedonisë dhe Shqipërisë po zhvillohet një betejë diplomatike për të përvetësuar atë”

Misionarja e shenjtë Nënë Tereza gjithë jetën e saj ia kushtoi njerëzve që vuanin për kujdesin njerëzor. Tek ajo, përkatësia njerëzore dominonte mbi ato etnike dhe jo rastësisht ajo e braktisi vendin e lindjes, Shkupin, për të qenë më afër atyre, që u mungonte ngrohtësia, përkushtimi dhe devotshmëria.

Sot, pas 105 vitesh nga lindja e saj, na duket absurde të luftohet për diçka, që ajo vetë, Nënë Tereza, sa ishte gjallë, asnjëherë nuk u angazhua. Ajo ishte shqiptare nga Shkupi, e lindur në rrugën “Koçina”, nr. 13, afër Qendrës së sotme Tregtare të Qytetit, e njohur me emrin GTC, në të djathtë të lumit Vardar, dhe në moshën 18 vjeçare e braktisi qytetin e lindjes për t’i përkushtuar botës së vuajtur.

Edhe ky jubile, 105 vjetori i lindjes është i rëndësishëm dhe lidhet me një figurë epokale e cili përshkoi më se një shekull dhe nuk ka se si të mos vështrohet në kontekstin e një atmosfere jotolerante, që po prodhon shoqëri konfliktuozë. Mosdurimi fetar e etnik që po karakterizon shoqërinë aktuale ka prekur edhe historiografinë maqedonase e cila fatkeqësisht po shkruhet me motive të politikës së ditës.

Në këtë kontekst na duket absurd edhe përpjekja për ta fshehur ose shtrembëruar origjinën etnike të Nënë Terezës, duke i mbathur asaj attribute gjenealogjike joshqiptare.

Të pretendosh ta zëvendësosh argumentin historik për nevojat e politikës ditore, ashtu siç vepron historiografia maqedonase gjatë tërë këtyre viteve, na duket një budallallëk me brirë. Kurora e këtij budallëku i është vënë pretendimit falso për origjinën vllehe, a maqedonase të Nënës Tereze, por pa spjeguar se si ishte e mundur një katolik të ishte vllehe a maqedonas, kur dihet botërisht se pjesa dërmuese e vlllehëve dhe maqedonasve janë orthodox.

Nga ana tjetër, qytetit i Shkupit nuk ka se si të mos ndjehet i obliguar për ta shënuar këtë jubile, siç është 105 vjetori, aty ku edhe është vendlindja e Nënës Tereze. Por, në asnjë mënyrë nuk guxohet të përzihet vendlindja me ndonjë interpretim tjetër të gabueshëm mbi preardhjen e saj. Askujt nuk i lejohet të arkëtoj ndonjë pikë në këtë çështje, e më së paku atyre që mundohen ta mohojnë origjinën shqiptare të saj, siç bënë Akademia Maqedonase me Enciklopedinë e vitit 2009. Shqiptarët nuk kanë nevojë dhe arsye të luftojnë për ta përvetësuar Nënë Terezën, sepse ajo personalisht në vitin 1995 do të deklarojë: “Me gjak jam shqiptare, me shtetësi jamë indiane dhe me zemër i përkas Jezu Krishtit”. Ata (shqiptarët) nuk kanë nevojë të angazhohen për diçka që u takon, që është e tyre dhe na duken me sens të munguar profesional edhe tekstet gazetareske, që e quajnë “luftë diplomatike” përvetësimin e Nënë Terezës.

Nëse do të konsiderohej përpjekja për ta përvetësuar me argument të falsifikuara figurën e Nënë Terezës, si “luftë diplomatike”, atëherë shqiptarët nuk kanë kurrëfarë nevojë të lëshohen në këtë arenë absurde (të pakuptimtë), sepse do të

tingëllonte qesharake kundërvënja që duhet të dëshmojë diçka që nuk ka nevojë të dëshmohet. Mohuesit, në këtë rast, politika zyrtare maqedonase dhe Akademia e Shkupit kanë arsye të ndihen të shqetësuar, kur argumentet e tyre i rrëzojnë për toke edhe kalamajtë.

Nënë Tereza nuk bëri vepra shkencore a letrare, as vepra pikturë, skulpturë, arkitekturë a muzikë. Kuptimin e jetës ajo nuk e kërkoi dhe nuk e gjeti në spjegimin e jetës – siç bëjnë shkencëtarët e filozofët, as në krijimin dhe në interpretimin e të bukurës – siç bëjnë politikanët dhe shtetarët. Kuptimin e jetës ajo e kërkoi dhe e gjeti në një fushë tjetër. Kuptimin e jetës ajo e kërkoi dhe e gjeti në atë që Papa Gjon Pali i II e quajti: “**NDERIM ABSOLUT I ÇDO KRIJESE NJERËZORE**”. Për këtë vepër ajo nuk shkroi gati asnjë rrjesht, për këtë vepër ajo jetoi. Duke qenë e madhe dhe modeste, në një rast Nënë Tereza shprehet: “E di se jemi një pikë në oqeanin e mjerimit dhe të vuajtjes njerëzore; por nëse nuk do të ishim ne kjo pikë mjerimi e vuajtje do të ishte edhe më e madhe”.

Bëmirësia e saj, është misioni i shenjtë i saj, është sistem shpirtëror dhe etik, është filozofi e saj jetësore.

Në emrin e këtij misioni ajo themeloi rendin e Motrave të Bëmirësisë. Me motrat e këtij rendi, ajo i dha domethënie të re, moralisht të re, mëshirës dhe bëmirësisë, e cila nuk ishte bëmirësi e foltoreve, e librave apo e ideologjive. Kjo ishte bamirësi e një prejardhjeje më të lartë, sepse ishte bëmirësi e motiveve më të thella e më të larta e të dlira njerëzore, pra kjo ishte bëmirësia e zemrës së madhe e të pastër.

Nënë Tereze ua kushtoi jetën atyre që nuk e kishin bukën dhe nuk e kanë sofrën, dhe atyre që nuk e kanë kulmin mbi kokë; dhe atyre që janë braktisur prej më të dashurve; atyre që

vuajnë prej sëmundjeve mendore; atyre të cilëve pa fajin e tyre janë goditur prej të këqijave që i sjellë natyra... Ajo ua fali jetën, me përulësinë më të shenjtë, të varfërve, të braktisurve, të harruarve, të përvuajturve – me një fjalë ua fali jetën dhembjemëdhenjëve më tragjikë të kësaj bote. Pra kështu, Nënë Tereze e kaloi jetën siç mund të pranojnë vetëm më të paktit dhe më të merituarit për nderim duke sjellë ngushëllime atje ku sundonte dhimbja, duke fshirë lot atje ku qajej, duke fshirë plagë atje ku plagët kullonin pa ndërprerë gjak, duke shtruar bukë atje ku sofrat ishin të zbrasta, duke sjellë shpresë atje ku dëshpërimi dhe pikëllimi ishin bërë shprehje e vetme....

Të shërbesh të varfërit – thoshte – domethënë të shërbesh jetën. Ajo bëri shtëpi bëmirësie në qytete të ndryshme të botës – prej Kalkutës së varfër e deri në Nju Jorkun e pasur. Ajo bëri shtëpi në të cilat iu zgjati jetën atyre që betejën për jetë e kishin humbur. Ajo bëri shtëpi ku do të vdesin ata që ishin në pragun e vdekjes. Dhe kështu, atyre që do të vdisnin në rrugë e nën ura, ajo u bëri të mundshme të vdisnin me kulm mbi kokë, siç duhet të vdisnin krijesat njerëzore. Ajo bëri shtëpi për fëmijët jetim. Dhe, kështu ua fali të drejtën e dashurisë atyre që ishin të dënuar të rriten pa dashuri.

Puna bëmirëse e Nënës Terezë ishte domethënëse jo vetëm për ata që e gëzuan këtë bëmirësi, por edhe për botën në përgjithësi. Bëmirësia e saj ishte ngushëllim për dhimbjemëdhenjtë, por bëmirësia e saj ishte njëherit edhe qortim për të gjithë të tjerët, që varfërinë dhe dhimbjet e të braktisurve i shikonin paanshëm. Siç u tha me vepritmarinë e saj bëmirëse, Nënë Tereze ia zbuloi botës faqen e padrejtësive, të cenimeve e të dhimbjeve që e rrezikojnë edhe faqen e saj të gëzueshme. Ajo ia zbuloi botës padrejtësitë e mëdha që

përmbajnë dallimet mes kastave dhe shtresave. Dhe, në këtë mënyrë, e bëri botën më të vetëdijshme për rrezikun që për njerëzimin përfaqëson ruajtja e ndarjeve të tilla klasike.

Nënë Tereze ia tregoi botës edhe padrejtësinë që shkakton ndarja e pa barabartë e pasurive mes shteteve, popujve dhe kontinenteve. Dhe në këtë mënyrë e bëri botën më të vetëdijshme edhe për tronditjet që një ndarje e tillë e padrejtë mund t'i sjellë njerëzimit.

Për tërë këto që u përmendën edhe për shumë e shumë gjëra të tjera, bota sot po e nderon Nënë Terezen, si misionare të paqës, bëmirisë dhe harmonisë në botë. Paqes botërore ajo, vërtet, i kontriboi në një mënyrë rishtaz të jashtëzakonshme. Ajo nuk e frymëzoi paqen me marrëveshje politike por me marrëveshjen e zemrave të njerëzve. Duke u kujdesur për të varfërit, të harruarit, të përvuajturit, të përlulurit. Nëna Tereze mundi dëshpërimin, pikëllimin dhe pezmatimin e tyre të vetëkuptueshëm. Duke ua kthyer shpresën atyre që e kishin humbur dhe duke ua kthyer dinjitetin atyre që ndjeheshin të përlulur e të fyer, ajo në të vërtetë i shtoi mundësitë e pajtimit e të marrëveshjeve në botë. Më në fund, duke e pakësuar sasinë e të këqiave, ajo i shtoi sasinë e të mirave në jetë. Është e kuptueshme, prandaj pse për të pas vdekjes nga goja e shumë shtetarëve politikanëve, artistëve e tjera u shqiptuan fjalë miradie e me peshë të madhe:

“Ajo është paqa në botë “ – De Kuelar;

“Nënë Tereze ishte grua që i dha formë historisë të këtij shekulli” – Papa Gjon Pali i II;

“Heroinë e kohrave tona” – Ronald Regan;

“Shëruese e madhe e plagëve të skamnorëve” – Akademik Idriz Ajeti;

“Arkitetkte e pallatit të dashurisë njerëzore” – Akademik Pajazit Nushi;

“Me vdekjen e Nënë Tereze bota mbeti me më pak dritë” – Zhak Shirak (Francë);

“Bota tani është më e varfër” – Gudjar;

“Nënë Tereza – ikonë e mbarë planetit” – Ismail Kadare”;

“Ajo preku zemrat e miliona njerëzve. Me vdekjen e Nënë Tereze bota ka humbur një nga gjigantët e ditëve tona... “ – Bill Klinton (SH.B.A).

“Humbje për paqën botërore” – Nelson Mandela.

“Dashuria tërheqëse – Nëna jonë Tereze – Bibliografia më i shquar i Nënës Terezë” – Don Lush Gjergji.

“Humbja e madhe për popullin shqiptar dhe për gjithë botën” – Imzot Sopi;

“Nëna e mirësis së botës” – heroinë më e madhe e shekullit – Akademik Rexhep Qosja.

Është e rëndësishme pse bota u tregua e vetëdijshme për madhërinë e punës dhe të botëkuptimit të Nënë Tereze. Është e rëndësishme dhe e kuptueshme pse bota i shprehu njohje të jashtëzakonshme kësaj pune, duke e shpërblyer me çmime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Dhurata e Paqës Gjoni XXIII më 1971, Xhon Kenedi 1971, Nehru më 1972, Nëna univerzale më 1974, Çmimi Nobel për Paq më 1979, Medalja Presidanciale e Lirisë e SHBA-së më 1985, Medalja e Artë e Kongresit Amerikanë më 1979 e tjera.

Ne, vëllezërit e saj më vonë se të tjerët u bëmë të vetëdijshëm për rëndësinë e veprës së saj bëmirëse gjithënjëzore. Përkushtimi që ndaj saj i treguan poetët, piktorët dhe skulptorët tanë, duke e amshuar në veprat e tyre, nuk na shfajësojnë pse aq shumë e vonuam shprehjen e mirënjohjes

për të gjitha ato që kjo Mbretëreshë e bëmirësisë bëri edhe për popullin e vet në botë. Në vitin 1997 Kardinali i Hungarisë u shpreh: “Nuk mund të jetë popull i vogël – ai që dhuron një NËNË KAQ TË MADHE”.

Në fund jam i bindur se do të pajtohemi nëqoftëse them se fjala për Nënë Tereze nuk është e nevojshme të përfundojë me shprehjen e zakonshme “Lavdi pastë emri i saj”, sepse lavdia e saj, edhe për të gjallët mbetet e përvetshme – pra e pavdekshme.

Lavdi e saj është lavdi botërore.

Për këtë arsye, emri i saj do të ndriçojë me dritën e yllit më të shkëlqyer ndër yjet e Shqipërisë...

Mesazhi i saj: Pa dashuri e flijim – jeta ska kuptim” – është mjaft kuptimplote!

Gjasat për shenjtërimin e Nënës Terezë nga ana e Selisë së Shenjtë janë të mëdha dhe e tërë bota e pret me padurim këtë moment, dhe jo vetëm ajo e krishterë, por të gjithë njerëzit humanë, të gjithë ata që kanë virtyte njerëzore dhe që kanë mbetur të mahnitur dhe të frymëzuar nga vepra e saj, që shënoi jo vetëm epokën e jetës dhe veprimtarisë së saj, por edhe tërë historisë e njerëzimit.

Dhe gjasat janë reale. Sipas paralajmërimeve që procedurat e Vatikanit të përfundojnë së shpejti dhe ajo formalisht të shpallet shenjtore me 5 shtator të vitit 2016. Është kjo ditë kur mbushen 19 vjet nga vdekja e Nënës Tereze, e që për nder të saj është shpallur nga Kombet e Bashkuara si Dita Ndërkombëtare e Bamirësisë.

Shenjtërimi i saj është lavdi botërore edhe për popullin shqiptar nga gjiri i së cilit lindi kjo engjëjleshë mirësie e dashurie.

DR. SEFER TAHIRI

*Bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Trashëgimisë
Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve–Shkup*

TENDENCAT PËR ZVETËNIMIN E IDENTITETIT ETNIK SHQIPTAR TË GONXHE BOJAXHIUT

Të gjithë e dimë se çfarë ka thënë Gonxhe Bojaxhiu–Nënë Tereza kur u pyet që ta përkufizonte vetveten, identitetin e saj. Cila është ajo? “Me origjinë dhe me gjak jam shqiptare, me shtetësi indiane, motër katolike. Përmes thirrjes sime i përkas tërë botës. Por zemra ime i takon vetëm Zotit”, ishin fjalët e Nënë Terezës të shqiptuara në Oslo, më datën 10 dhjetor të vitit 1979. Këto fjalë dëshmojnë qartë nga vet Nënë Tereza identitetin e saj, i cili te kjo figurë botërore është universal dhe specifik, është identitet global dhe lokal, botëror dhe shqiptar.

Më 8 mars të vitit 1978, Nënë Tereza erdhi në kryeqytetin e Maqedonisë, Shkup, në hapjen e shtëpisë “Misionarët e dashurisë”, ndërsa në këtë ngjarje shprehu fjalë falenderuese për shqiptarët. “Ky është akt falenderimi që unë kam marrë nga familja ime, prindërit e mi, familja e zemrës së Krishtit, nga populli im shqiptar, qyteti im, njerëzit e mi. Motrat e mia janë dhuratë për popullin tim, për ipeshkvinë time”.

Nga këto dy pohime nga vetë goja e Nënë Terezës, shihet qartë se ajo asnjëherë nuk e ka fshehur prejardhjen dhe përkatësinë identitare etnike shqiptare. Duke qenë humaniste, duke pasur një mision tërësisht, kryekëput njerëzor Gonxhe Bojaxhiu, më pas Nënë Tereza gjithmonë ka folur në

dimensionin kosmpolit, pra mbietnik, por asnjëherë pa harruar popullin shqiptar.

Në ditën e hapjes së Shtëpisë së Budapestit, më 17 qershor të vitit 1980, në një bisedë me të, biografi i saj shqiptar, Don Lush Gjergji, e luti të bëjë një porosi për popullin shqiptar, i cili në atë kohë përjetonte çaste të rënda. Nëna Tereza u shpreh:

Po, unë gjithmonë bart në zemrën time popullin tim shqiptar dhe i lutem Zotit për paqe dhe prosperitet, për një të ardhme më të mirë. Lutem që urata t’iu bashkojë me Zotin dhe me njeriun, me tërë botën. Dëshiroj t’i vizitoj motrat e mia në ipeshkvinë tonë, në Shkup dhe në Pejë, sa më parë, që të jemi prapë bashkë. Shpirtërisht unë jam gjithmonë me Ju. Sa bukur! Është mrekullia e Zotit, dashurisë së tij, që na bashkon. Dëshiroj t’i përshëndes të gjithë me këto fjalë: “Ju dua, Zoti ju do, Zoti ju bekoftë”.

(Gjergji L, 2010:210)

Më pas kishte marrë bllokun e Don Lush Gjergjit dhe kishte shënuar: “Unë gjithmonë lutem për popullin tim shqiptar, që paqja e Krishtit të sundojë në çdo shtëpi, në çdo familje dhe në tërë botën. Zoti qoftë me Ju”.

Edhe pse ajo vetë ka pohuar origjinën e saj etnike, në Maqedoni, në socializëm, por dhe në sistemin pluralist gjithmonë nga qarqet akademike—shkencore dhe sidomos mediat është shfaqur tendenca e mohimit apo kamuflimit të identiteti të saj etnik, që nënkupton dimensione të ndryshme: vetidentifikimin dhe ndjenjat rreth përkatësisë ndaj një grupi të caktuar etnik. Identiteti etnik, shpesh përfshin një ndjenjë

të përbashkët të origjinës dhe historisë, që i lidh anëtarët e grupit etnik. Pra, edhe pse vetë Nëna Terezë ka pohuar se është shqiptare në aspektin e identitetit etnik, qarqet e ndryshme asnjëherë jo që nuk i kanë dhënë rëndësi, por me propagandë janë kujdesur që të mos e nxjerrin në sipërfaqe këtë dimension të Gonxhe Bojaxhiut.

Vetë emri i saj tregon se Gonxhe Bojaxhiu rrjedh nga një familje shqiptare e besimit katolik. Sipas fjalorit të gjuhës shqipe gonxhe do të thotë lule që s'ka çelur ende, burbuqe. (*Gonxhe trëndafili (karafili). Gonxhet e kumbullës, e pjeshkës, e bajames. Çelën gonxhet. Është si gonxhe, është e re, e bukur e plot shëndet, zakonisht për vajzat e për fëmijët*).

Ky është spjegimi që jep fjalori dhe që hudh në ujë pretendimet me qëllime politike ose propagandistike të të gjithë pseudointelektualëve, të cilët në mungesë argumentesh nuk mund të thonin drejtpërdrejt se është maqedonase, por spekulonin se ka origjinë vllehe.



Diskursi përjashstues apo që mohon çdo lidhshmëri mes Gonxhe Bojaxhiut dhe etnisë shqiptare nuk ka qenë i pranishëm vetëm në politikbërje, në veprimin institucional, aktivitetin diplomatik, por ka qenë i pranishëm sidomos në media dhe në pretendimet shkencore, që shpesh u ngjasonin pamfleteve politike të porositura nga qarqe të caktuara dhe segmente të pushtetit.

Në botimin e shtëpisë botuese MI-AN me titull “Personalitetet e Maqedonisë-emërori enciklopedik”, Nëna Terezë është shkruar si vllehe apo e përkatësisë etnike vllehe (<http://star.dnevnik.com.mk/default.aspx?pbroj=2275&stID=23808>). Autorë të veprës që u botua në mars të vitit 2006 janë Petar Karajanov, Hristo Andonov dhe Jovan Pavlovski. Botini i kësaj vepre është bërë me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës. Në këtë botim janë publikuar 22 mijë zëra nga fusha të ndryshme, si personalitete, ngjarje historike, ekonomike, politike, gjeografike, kulturore, religjione botërore, flora e fauna etj.

Një ndër enciklopeditë më të besueshme në botë është “Enciklopedia e përgjithshme” e Oksfordit. Në të, për Nënë Terezën shkruan: “Tereza, Nënë (emri i lindjes Agnes Gonxhe Bojaxhiu)...Murgeshë dhe misionare katolike, e lindur në Maqedoninë e sotme nga prindër shqiptarë”, Enciklopedia e përgjithshme, Oxford, botimi shqip, Tiranë, 2006, f. 1241. Një tjetër enciklopedi shkruan: “Tereza, Nënë, emri i vërtetë Gonxhe Bojaxhiu, emri misionar Nënë Tereza, misionare; e lindur në Shkup. Për kah nacionaliteti – shqiptare. (Opća Enciklopedija Jugoslavenskog Leksikografskog Zavoda, Zagreb, 1982, libri 8, f. 183).

Më 11 gusht të vitit 2010, në Krushevë, që njihet si qytet ku jeton popullsi që i takon përkatësisë etnike vllehe, në kuadër

të manifestimit “10 ditë Republika e Krushevës”, u shënua 100 vjetori i lindjes Nënë Terezës.

Me këtë rast, drejtori i manifestimit, Pande Llazarevski, një intelektual i njohur, 10 vjet drejtor i Institutit të Hulumtimeve Sociologjike, Politike dhe Juridike në Shkup, sot ambasador i Maqedonisë në Bukuresht do të pohojë:

Maqedonia është krenare që në krahët e saj ka Nënë Terezën—krenari dhe dritë e gjithë Maqedonisë, popullit vllëh dhe gjithë botës. Komuniteti vllëh me krenari e përjeton vllëhen Nënë Terezën—noastra Dada Thereza si më të vlefshmen që ndaj Maqedonia me botën. Pikrësiht për këtë, komuniteti i vllëhëve në Republikën e Maqedonisë, i cili është pafundësisht falenderues miratoi vendimin, me të cilin themeloi çmimin për humanitet “Nënë Tereza”.

<http://mm.mk/kultura/2362-Vo-Krusevo-odrzana-svecanost-po-povod-100-godini-od-raganjeto-na-Majka-Tereza>

Në fakt në Maqedoni ka pasur polemika të shumta se e kujt është Nënë Tereza!

Profesroresha Millka Zdraveva, në numrin 21979 të gazetës së përditshme “Nova Makedonija”, në datat 8 maj (e premte) dhe 10 maj (e hënë) botoi fejtonin në dy vazhdimë me titull “Vallë Nënë Tereza është vetëm shqiptare?” Në këtë shkrim thuhet:

Familja e Gonxhe Bojaxhiut (sipas linjës së babait), sipas Stojan Trençevskit, përmendet në Shkup, në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, por të dhënat tregojnë për

stërgjyshin e saj, Niko tregojnë për kohën pas vitit 1830. Më pas jepen më shumë të dhëna për gjyshin Llazar dhe gjyshen Çilla, si dhe prindërit Nikolla dhe Drona. Më lartë është thesuar se nëna e Gonxhes është me prejardhje romako-katolike krishtere. Gonxhe Bojaxhiu është e lindur në Mëhallën vllehe në Shkup. Profesioni i vjetër familjar—ai i bojaxhiut dhe klientët më në numër—vlllehët, gjithashtu asocon në prejardhjen vllehe të Bojaxhiut. Në këtë kontekst janë edhe bisedat e Stojan Tërçevskit me artarin Toni Josifovski. Sipas mendimit të Dimo Dimçevit, njohës i historisë së vlllehëve, Gonxhja ka prejardhje vllehe, ndërsa qëndrimin të njëjtë ka edhe profesorja e historisë Athina e familjes Niçota, e cila thotë se Gonxhe është emër vllleh. Edhe Unioni i vlllehëve në Manastir konsideron se Gonxhja ka prejardhje vllehe. Duke pasur parasysh kushtet historike në këtë hapësirë, përzierjen e popullatës, edhe pse jo shpesh, por edhe ndërrimin e religjionit dhe etnisë, konsiderojmë se Gonxhe Bojaxhiu ka prejardhje vllehe.

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=510101033546&id=13&setIzdanie=21979>

Identiteti i Nënë Terezës nuk ka qenë betejë e debateve mediatike, politike dhe shkencore—akademike, por edhe diplomatike. Shqipëria ka zhvilluar luftë diplomatike ndaj çdo tendence që Nëna Terezë të prezantohet si maqedonase. Ambasadori i Shqipërisë në Vatikan, Zef Bushati në vitin 2012 ka deklaruar se nuk është kontestuese që Vatikani me notë zyrtare ka dhënë përgjigje kategorike se Nëna Tereze ka qenë dhe është shqiptare. Ai ka theksuar se Vatikani ka kërkuar që

gjithmonë kur flitet për Nënë Tereze, të theksohet edhe përkatësia e saj etnike shqiptare. “Vatikani ka premtuar që nuk do të lejojë një padrejtësi të tillë, përkatësisht Nëna Tereze të prezantohet si bijë maqedonase”, ka deklaruar Bushati.

(<http://star.dnevnik.com.mk/?pBroj=2204&stID=20782>)

Shtypi shqiptar shkruante se edhe prefekti I Romës, Vallter Valtroni, i ka premtuar ambasadorit të mëparshëm shqiptar në Romë, Pëllumb Xhufi, se nuk do të lejojë “provokime dhe incidente gjatë shpalljes së lumturimit të Nënë Terezës”. Një pjesë e shtypit shqiptar e akuzonte Maqedoninë për “përvetësimin e nobelistes shqiptare”. Në gazeta shkruhej se pseudohistorianët maqedonas edhe më parë kanë tentuar që shqiptarët e spikatur t’i prezantojnë si maqedonas, siç ka qenë rasti me heroin kombëtar shqiptar—Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe me reformatorin e madh muzikor Gjon Kukuzeli nga Durrësi.

Edhe pse vetë Nënë Tereza ka thënë se është qytetare e botës, duke qenë kosmopolitane me vepra dhe përkushtim, në tentim për të theksuar identitetin e saj territorial a gjeografik të origjinës, pra të qytetit të Lindjes—Shkupi, vite me radhë ka funksionuar Shoqata Joqeveritare “Shkupjanja Nënë Tereza”, e drejtuar nga gazetari Stojan Trençevski, i cili më 8 shkurt të vitit 2015 ndërroi jetë dhe nuk dihet se cili do të jetë fati I kësaj shoqate. Trençevski, autor i librave “Nëna jonë”, “Shkupjanja Nënë Tereza”, “Rrugëve të fëmijërisë së Nënë Terezës”, libra të përkthyer në gjuhën angleze, italiane, spanjolle, gjermane, polake dhe bengale dhe njëkohësisht edhe autor i filmit “Nëna”, gjithmonë ka afirmuar tezën mbi identitetin shkupjan të Gonxhe Bojaxhiut, madje shpeshherë

duke kërkuar gjurmë vllehe në historinë e trungut të saj familjar.

Më 30 janar të vitit 2009 përfundoi ndërtimi i Shtëpisë përkujtimore për Nënë Terezën, e ndërtuar sipas projektit të arkitektit Vangell Bozhinovski, i njohur për angazhimin e tij në projektin “Shkupi 2014” dhe që sipas vlerësimeve të ekspertëve të arkitekturës dhe estetikës, objekti i Shtëpisë Përkujtimore lë shumë për të dëshiruar.

Në faqen e internetit të këtij institucioni, që është në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe anglisht theksohet se kjo shtëpi është rezultat i realizimit të idesë dhe dëshirës për ta respektuar shkupjanen më të njohur dhe nobelisten e vetme nga Maqedonia. Shtëpia Përkujtimore e Nënës Terezë është organizatë jofitimprurëse e finansuar nga Ministria e Kulturës. Sipas të dhënave të faqes së internetit të këtij institucioni vendi i vet Shtëpisë Përkujtimore nuk është zgjedhur rastësisht.

Pikërisht në këtë vend deri në tërmetin e vitit 1963 gjendej Kisha Katolike “Zemra e Shenjtë e Krishtit”, në të cilën Nëna Terezë, atëherë Gonxhe Bojaxhiu është pagëzuar vetëm një ditë pas lindjes, në këtë kishë ajo mori kungimin e parë dhe e gjeti paqen e vet shpirtërore pas vdekjes së babait, kur familja Bojaxhiu bie në krizë të thellë financiare. Ky vend ka pasur rëndësi dhe ndikim të veçantë në formimin e karakterit të Gonxhes së re dhe dëshirës së saj t’ju ndihmoj atyre, të cilët më së shumti kanë pasur nevojë për ndihmë, dhe e cila që nga vitet më të hershme të jetës së saj të fëmijërisë, jo vetëm që këndonte në korin e kishës, por edhe merrte pjesë në aktivitete bëmirëse. Në njëfarë mënyre, vetë vendi paraqet një urë simbolike midis

shkupjanes së re Gonxhes dhe njëres prej humanisteve më të mëdha në botë, Nënë Tereza.

<http://www.memorialhouseofmotherteresa.org/sq/per-muzeun/hyrje>

Nga struktura e menaxhimit dhe kustosëve-udhëheqës rezulton se nuk ka asnjë shqiptar. Drejtore është Renata Zofija Kuterá – Zdravkovska me titull – magjistre e menaxhimit të kulturës dhe artit. Ndërsa kustos-udhëheqës janë Andriana Jeliq, historiane e artit – arkeolog dhe Dragan Kostiq, filolog, të cilët u shpjegojnë rreth 100 mijë turistëve në vit mbi Nënë Terezën, të cilët vijnë jo vetëm nga Europa dhe SHBA-ja, por edhe nga shtete si Nikaragva, Kili, Izraeli, SHBA, Guatemala, Havai, etj. Sipas të dhënave zyrtare në këtë institucion nuk ka pasur të punësuar asnjë shqiptarë, ndërsa së fundi është punësuar Margarita Sereçi, edhe atë në sektorin e marketingut.

Institucioni Shtëpia Përkujtimore “Nëna Terezë” ka promovuar monografinë kushtuar këtij institucioni, e botuar në vitin 2012 në gjuhën maqedonase, shqipe dhe atë angleze. Monografia përmban informacione për idenë, gjenezën dhe fazat e ndërtimit të Shtëpisë-muze për shkupjansen më të njohur, humanisten dhe nobelisten Nëna Tereze.

Monografia është e begatuar me shumë fotografi, përmban tekste nga më shumë autorë, në të janë përfshirë edhe fjalimet e hapjes solemne të muzeut dhe fjalimet e akademisë me rastin e 100 vjetorit të Gonxhe Bojaxhiut dhe janë botuar edhe përshtypjet e vizitorëve. Libri është konceptuar nga redaksia profesionale në përbërje: akademik Katica Qulafkova, Valentina Bozhinovska, Agim Poloska, Aleksandar Gjorgjiev dhe Marjan Ristov.

Akademik Qulafkova theksoi se Shtëpia–Përkujtimore gjendet në një vend të shenjtë (kisha), ndërsa duke folur mbi identitetin e Nënës Terezë u shpreh:

“Sërish flasim për Nënë Terezën dhe flasim mbi storjen për një shkupjane, maqedonase, një grua që me prejardhje është shqiptare, vllehe, e cila për nga jeta është misionare, e cila si qytetare i takon Indisë dhe gjithë botës, e cila është nobeliste dhe ballafaqohemi me faktin se, në esencë, shkruajmë për një tregim për një kolose, e cila tashmë nuk është vetëm personalitet historik, por simbol që lidh botën dhe kohërat, ndërsa shpresoj se do të na lidh edhe neve në Maqedoni”.

Përmendoren e Nënë Terezës ishte paralajmëruar se do t’a ndërtonte biznesmeni apo oligarku indian Subrata Roj, kompanisë së të cilit “Sahara Global” për këtë qëllim në vitin 2013 i ishte dhënë truall prej 621 metrash katrorë në Sheshin “Maqedonia”.

Personaliteti i Nënë Terezës ishte planifikuar të respektohet nga shteti i Maqedonisë me ndërtimin e përmendores së humanitetit, edhe atë siç u shpreh dhe u zotua Roj për nder të “gruas më humane, maqedonases, Nënë Tereza, bëmirëses që i bashkoi Maqedoninë dhe Indinë”.

Pas skandalit dhe burgosjes së biznesmenit indian, kryeministri Gruevski në kongresin e VMRO–DPMNE në Kumanovë në vitin 2015, bëri të ditur se përmendorja do të ndërtohet me buxhet shtetëror dhe se sa i përket vendosjes së përmendoreve, me të do të përfundojë projekti “Shkupi 2014”. (<http://lajmpress.com/lajme/maqedoni/72564-5-milione-e-600-mije-euro-shtese-per-permendoren-e->

nene-terezes.html). Ministria e Kulturës nënshkroi marrëveshje me kompaninë ndërtuese “Beton” në vlerën e 5 milionë e 600 mijë eurove për ndërtimin e përmendores së Nënë Terezës. Sipas bazës së të dhënave “Shkupi 2014 nën llupë” të cilën e publikoi Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese BIRN-i, muajin e kaluar, shuma për ndërtimin e përmendores arriti vlerën 10 milionë e 700 mijë euro, bashkë me punimin e projektit fillestar, zgjidhjen ideore dhe kontratën për ndërtim. Me marrëveshjen e re të nënshkruar, në mënyrë drastike u rrit edhe shuma që kompania ndërtuese “Beton” arkëtoi nga projekti “Shkupi 2014”.

Për fund, përgjigje më e mirë kundër tendencave për zvetënimin e identitetit etnik shqiptar është ajo e komunitetit të shkrimtarëve, intelektualëve dhe artistëve shqiptarë nga mbarë hapësira etnike shqiptare. Në reagimin me titull “Kundër tendencave të grabitjes së ikonës sonë, Nënës Terezë”, i publikuar më datën 03 shkurt të vitit 2009 thuhej:

Me ikonën tonë kombëtare Nënë Terezë, nuk duhet lejuar të luhet, të abuzohet, e, më së paku, ajo nuk mund të përvetësohet. Nëna Terezë nuk mund të shpallet vlerë e askujt, ngase ajo është vlerë e gjithë njerëzimit, por, mbi të gjitha, ajo është e gjakut dhe rrënjëve shqiptare, argument ky që s'do koment, ngase si i tillë është i mirënjohur në gjithë globin, ku dihet e shkruhet për ikonën tonë kombëtare, Nënë Terezë. Këtë fakt ajo e ka vulosur me fjalët e saj, me dëshmitë e saj, me shkrimet dhe intervistat e saj, e mbi të gjitha, me vetë atë që është jeta e saj. Në këtë kontekst, ne komuniteti i shkrimtarëve, intelektualëve, artistëve shqiptar të kudo ndodhur, e vlerësojmë tejet fyese

tendencën maqedonase për të nëpërkëmb identitetin e saj shqiptar, nëpërmjet lojës së ligë që po luhet me Shtëpinë Përkujtimore në emër të nobelistës sonë, Nënës Terezë, ku thuhet se gjitha sendet dhe materialet që do të prezantohen, janë në gjuhën maqedonase. Ne jemi të indinjuar thellë me këtë akt joqytetërues dhe së këndejmi shprehim revoltën tonë kundruall kësaj tendence të marrë, tendencë kjo që përpiqet të kulmon me ndërtimin e Kishës Ortodokse mbi themelet e shtëpisë së Nënës Terezë.

Më tej në këtë reagim thuhej si vijon: “Për ne nuk është asgjë e re tendenca qëllimkeqe, e cila vjen nga shteti maqedonas për të përvetësuar ikonën tone, Nënë Terezë, nëpërmjet zhbërjes së gjurmëve e të rrënjëve të saj. Kjo përpjekje dashakeqe është në vazhden e tendencave të kohëpaskohëshme që shfaqin mendjet e marra, për të përvetësuar figurat tona madhore, shenjat e identifikimit kombëtar nga fqinjët tanë gllabërues. Rasti i përrurimit të Shtëpisë Përkujtimore kushtuar humanistes dhe të lumes Nënës Terezë, dëshmon edhe njëherë sheshazi se shteti maqedonas me gjithë aparaturën e tij është vënë në shërbim të idesë së marrë për të tjetërsuar identitetin e Nënës Terezë, nëpërmjet maqedonizimit të saj dhe zhdukjes së gjurmëve të saj shqiptare, në Shkup”, thuhej në reagim.

Tendencat për zvetënimin e identitetit të saj etnik nga qarqe të caktuara politike dhe akademike maqedonase janë të qëllimshme dhe me konotacion politik, ndërsa njëkohësisht paraqesin siç do të shprehet komuniteti i intelektualëve shqiptarë “një precedencë alogjike, absurde, aspak humane dhe shumë djallëzore që më së paku ndihmon marrëdhëniet

ndëretnike në këto pjesë të trazuara të botës. E, mbi të gjitha kjo mënyrë e të abuzuarit me këtë Shenjtëreshë shqiptare, nuk i shkon për shtati humanizmit, emrit dhe veprimtarisë së Nënës Terezë, e cila tërë jetën e saj ja ka kushtuar paqes, dashurisë dhe marrëdhënieve të mira mes njerëzve në përgjithësi”.

Vizitat në Shkup

Maj 1970

Vizita e parë në Shkup. Gjatë qëndrimit të saj të shkurt në Shkup, asaj i kujtohet takimi me kryepeshkopin Joakim Herbut dhe vizita e saj në Kryqin e Kuq të Maqedonisë.

27 Mars 1978

Vizita e dytë në Shkup, nxiti interes të madh nga mediat, pasi që ajo më është e njohur në tërë botën. Për nder të saj është mbajtur mesha në Kishën Katolike.

27 Qershor 1980

Vizita e tretë në Shkup. E mirëpret prefekti i Shkupit, z. Metodi Antonov, i cili i drejton urime me rastin e marrjes së çmimit Nobel dhe e shpall qytetare nderi të Shkupit. Atëherë Nëna Tereze kishte thënë “Kam marrë shumë mirënjohje në botë, e morra (1979) edhe Çmimin për Paqe Nobel, por mirënjohjen e bashkëqytetarëve të mi e kam shumë të vlefshme dhe do ta ruaj afër zemrës”.

19 Shtator 1986

Vizita e saj e fundit në Shkup. Takoi kryepeshkopin Herbut dhe siguroi selinë e misionit të saj në lagjen "Kisella Voda".

FADIL CURRI

Shkrimtar dhe studiues i letërsisë

PSE PO STRUKET HISTORIA SHQIPTARE E SHKUPIT?



Autoriteteve maqedonase, por edhe disa biografëve, ua ka ënda që ta njohin universalizmin e Nënë Terezes, e jo edhe shqiptarësinë e Gonxhe Bojaxhiut të Shkupit, në të cilin qytet do të duhej të për-qëndrohej jeta politike, uni-

versitare, kulturore e civilizuese e pluralizmit shqiptar të Maqedonisë

Që bie në sy vitet e fundit, në Shkup anashkalohet mohueshëm historia shqiptare e këtij qytetit që nga lashtësia e deri më sot, fragmentohet e tangjentohej ajo. Nëse dikush i lexon studimet e botuara të Dr. Gaspër Gjinit, letërkëmbimet e Pjetër Bogdanit me Selinë e Shenjtë, do të bindet se vazhdimësia iliro-shqiptare në këtë qytet me rrethinë të gjerë është e pamohueshme, faktike e domosdo e zbulimeve të reja jo vetëm shqiptare. Nuk është utopi e panegjerizëm nëse shkruhet se Shkupi është kryeqytet historik i Dardanisë dhe i Kosovës së deri vitit 1912, i Vilajetit të saj.

Duket se po e strukin përdhunshëm edhe sot historinë e identitetin shqiptar të Shkupit, duke ia mohuar figurat e saj. Në varganin e shtatoreve e busteve, përmendoreve sheshit të tij, urave të sapondërtuara brigjeve të Vardarit, figurave u

mungojnë emrat shqiptarë. Është për habi se si gjetën vend përmendoret grandioze të Filipit II(dhëndër ilir, mbase edhe vet ilir), gruas së tij ilire(Olimpias) dhe djalit të tij(Lekës–Aleksadnrit të Madh) këndeje e andej lumit. Mbase mund ta kenë bërë si mëri antigreke për shkak se nuk e njohin emrin ~ Maqedon(i), por strukja e historisë, fshehja e së vërtetës për hisen shqiptare të këtyre figurave historike rezulton edhe ngathtësinë shqiptare.

Sot vendnumërimi shqiptar përballë shkathtësisë vendimmarrëse e propaganduese ndaj shqiptarësisë së Maqedonisë është falsifikuese e retrogarde. Bie fjala, strukja e elementit shqiptar ortodoks të dhjeta fshatrave shqiptare deri në gati asimilim aktual, pastaj zbëria e katolicizmit shqiptar, është etnocentrizëm sllav nën petkuin pushtetar.

Nobelisten bamirëse Gonxhe Bojaxhiu alias Nënë Tereze nuk e njohin si shqiptare, por vetëm si shkupiane, bile mëtojnë t’ia nxjerrin edhe zënafillën joshqiptare dhe kjo qasje nuk i indihmon shqiptarizëm, si do ta quante ndjenjën kombëtare Branko Merxhani. Këmbëngulja e disave, qofshin edhe biografë të Nënë Terezës, që ta afirmojnë këtë figurë vetëm me vlera globale e universale, lë mbresën se bëhet me anashkalim të burimit shqiptar, se duan më shumë ta nderojnë si misionare universale Nënë Terezen, e jo edhe si shqiptaren nga Shkupi, Gonxhe Bojaxhiun. Edhe gjurmët e shtëpisë së saj duan t’ia strukin e rrënojnë, t’ia zbëjnë kujtesën shqiptare për të, paraprakisht duke e indentifikuar si “Shkupianja Nënë Tereze” pse është e lindur në Shkup ose si e përkatësisë vllahe, pse ka jetuar në rrugën “Vllashka ulica”(Rruga, lagja e vllahëve).

Mishërimi i shqiptares Gonxhe Bojaxhiu dhe nobelistes humanitare, Nënë Tereze, për vendlidjen e saj, Shkupin,

vërehet në poezinë "Lamtumirë, e shkruar rrugës për misioidin e saj të shenjtë për në Indi, sidomos në strofat e para. Nocione thelbore të dashurisë dhe pashkëputshmërisë janë shtëpia, vendlindja dhe njerëzit e dashur. Epiteti zemërfanar për shtëpinë me vatrën e saj, njerëzit identifikohen me fërefisin, të afërmit, nënën e dashur janë vokacion poetik i poetes Gonxhe Bojaxhiu në përshfaqjen e dashurisë. Të gjitha këto dhimbje të lidhura me qytetin e saj të lindjes, Shkupin, të cilat i braktis që t'i shërbejë Krishtit të saj .Shqiptarësinë e shkupianes Gonxhe Bojaxhiu ose nobelistes Nënë Tereze e vërejmë në fjalët tejet humanitare të saj: ""Un jam shumë tuj u lut për ju – qi dashnija e Zotit t'mush zemrat e juja dhe gjith botën", me një shqipe të gegërishtes kosovare të Shkupit, si ishte zënafilla prindore nga nëna e babai i kësaj figure me nam botëror.

Kthimi i rëndësisë shqiptare të Shkupit duhet të bëhet më faktologji merituese. Është mirë të përmirësohet gabimi i hyrjes shqiptare në pluralizmin e Maqedonisë pa busollë, kur partitë, shoqatat, klubet, pastaj edhe universitetet selitë e tyre i vendosën në periferi të epiqendrës ndërkombërate, diplomatike e zhvillimore, në vend që këtë ta bënë në Shkup, ku kishte më shumë arsye e nevojë, aty ku e kërkonte më së shumti realja e garimi civilizues i komuniteteve etnike të Maqedonisë do të ishte i jonjëanshëm. Margjinalizimi i Shkupit edhe nga organizimi i subjekteve shqiptare e dëmtoi të vërtetën dhe strukjen e saj të segmentit historiko–aktual të etnisë shqiptare, pjesën krishtere(ortodokse e katolike) të saj dhe shqiptarësinë nëntereziene. Deetnizimi i shqiptares Gonxhe Bojaxhiu dhe globalizimi i Nene Terezës janë tendenca të minimizimit të një faktologjie shqiptare të përdëftuar, në anë tjetër maksimalizim i inekzistencës prepotente lidhur me segmentet Shkupit historik e aktual.

DON VIKTOR SOPI

Drejtor i Organizatës Humanitare “Caritas Kosovë”

“NËNË TEREZA NË VIZIONIN E PERSONALITETEVE BOTËRORE”

HEROINA E KOHËS SONË

Është e pamundur të jesh në praninë e një personi si Nënë Tereza, e të mos e shikosh botën me më shumë optimizëm...Këtë grua e kemi dëgjuar në heshtje, me vëmendje dhe dashuri, porsì heroinën e kohës sonë.

Ronald REGAN, president amerikan

SONTE KA MË PAK DASHURI...

Sonte, ka më pak dashuri, më pak ngushëllim, më pak dritë në botë. Ajo na la me një mesazh të fortë, që nuk ka kufi dhe që tejkalon besimin: ndihmë, dëgjim dhe solidaritet.

Jacques CHIRAC, president frëng

AJO U DHA TË VARFËRVE TRIMËRI...

Ajo u ndihmoi varfërve, u dha trimëri të jetojnë me ndjenjën e vlerës së tyre. Nënë Tereza do të mbetet e paharruar dhe do të jetë një shembull pas vdekjes së saj.

Helmut KOHL, kancelar gjerman

ISHTE E GATSHME PËR NDIHMË NË ÇDO KOHË

Gjithë jeta e kësaj gruaje të madhe ishte mishërimi i shndritshëm i shërbimit ndaj idealeve të larta të mirësisë, dhembshurisë dhe besimit. Nënë Tereza do të mbetet

gjithmonë në zemrat dhe mendjet e rusëve si shoqe e shtetit tonë, e gatshme të jepte ndihmë në çdo kohë.

Boris Jelcin, president rus

NËNË TEREZA PAQË NË BOTË

Nënë Tereza është Kombet e Bashkuara. Ajo është paqë në Botë.

*Javier Perez de CUELLER,
Ish-sekretari i përgjithshëm I OKB-së*

...DO TË KETË VETËM NJË NËNË TEREZË

Shtëpia për njerëzit që po vdisnin, të cilën ajo e hapi në Kalkutë, thujse gjysëm shekulli më pare quhet “Nirmal Hriday” që do të thotë “Zëmër e Pastër” dhe, nëse një here pa pasur zemër të pastër, ajo ishte zemra e Nënë Terezës... Mbretërit, mbretëreshat, presidentët, kryeministrat, patriarkët dhe papët vijnë dhe shkojnë, poashtu edhe fituesit e çmimit “Nobel”, por do të ketë vetëm një Nënë Terezë.

Bill KLINTON, ish-presidenti amerikan

NËNË TEREZA GRUA E VENDOSUR

Nënë Tereza ishte grua e vendosur dhe e gëzueshme, ajo shërbeu me vetëmohim dhe me dashuri, pa dyshim, u dha paqe shumë e shumë të tjerëve. Sot ndërsa po i themi lamtumirën e fundit Nënë Terezës na kujtohet përsëri mësimi i saj se, të ushqesh fëmijë, të mbyllësh një plagë dhe të kujdesesh për ata që janë duke vdekur, ndihmon, në fund të fundit, në përmirësimin e shpirtit njerëzor.

Hilari KLINTON, politikane.

NËNË TEREZA PERSONALITET RELIGJIOZ

Nënë Tereza ishte njëra prej personaliteteve më të mëdha religjioze të epokës sonë. Urtia e përvuajtur e saj shprehte përshpirtërinë pa precedente. Edhe lutjet e saja precise, si edhe mendimet për uratën janë një tjetër dhuratë tejet e çmueshme për botën.

Jimmy CARTER, president amerikan

NJË HUMBJE PËR MBARË NJERËZIMIN

Një humbje për mbarë njerëzimin. Do të mungojë thellë në përpjekjet tona të ndërtojmë paqen ndërkombëtare dhe një rend botëror të drejtë, të kujdesshëm dhe të barabartë.

*Nelson MANDELLA,
President i Afrikës Jugore*

NËNË TEREZA SHEMBULL I PËRKUSHTIMIT

Një shembull i përkushtimit vetëmohues ndaj bamirësisë. Shpresoj se ajo mund të jetë shembull ndaj të gjithë punëtorëve mirëbërës dhe filantropëve.

*Mahathir MOHAMAD,
kryeminister malajzian*

NJË INDIVID I RRALLË I QËLLIMEVE TË LARTA

Një individ i rrallë dhe i vetëm i cili jetoi gjatë për qëllime më të larta. Përkushtimi i saj i përhershëm ndaj të varfërve, të sëmuarëve dhe të vuajturve ishte nga shembujt më të lartë të shërbimit ndaj njerëzimit.

Nawaz SHARIF, kryeministër i Pakistanit

VEÇORIA E NËNË TEREZËS RESPEKTI PËR NJERIUN

Veçoria e punës së saj ka qenë respekti për njeriun, për vlerat dhe dinjitetin e tij. Më të mjeruarit, më të vetmuarit, fatkeqët që po vdesin, leprosët e braktisur, janë pranuar nga ajo dhe Motrat e saj me dashuri dhe ngrohtësi, pa përbuzje, por të mbështetura mbi respektin për Krishtin të njeriu...Në sytë e saj njeriu, i cili, në rastin konkret, është marrësi, është gjithashtu edhe dhënësi dhe është ai që jep më shumë, nga se merr. Dhënia – dhënie e diçkaje nga vetja – është ajo që të jep kënaqësi të vërtetë, dhe njeriu që ka mundësi të japë, është ai që merr dhuratën më të çmuar. Atje ku të tjerët shohin klientë ose myshterinj, ajo sheh bashkëpunëtorë, një lidhje që nuk bazohet në praninë e mirënjohjes nga njëra palë, por në mirëkuptimin e ndërsjellë, dhe në një ngrohtësi njerëzore e në afërsinë që të pasuron...Kjo është jeta e Nënë Terezës dhe Motrave të saj – një jetë e një varfërie të ngurtë e ditëve dhe e netëve të gjata në jetë, ku nuk ka vend për kënaqësi të tjera, por që është më e çmuara...

*Xhon SANES,
Kryetar i komitetit Nobel të Suedisë*

AFIRMUESJA E PATJETËRSIMIT TË DINJITETIT NJERËZOR

Nënë Tereza e meriton Çmimin Nobel për Paqe, sepse ka nxitur paqen në mënyrën më kryesore, duke afirmuar patjetërsimin e dinjitetit njerëzor.

*Robert S. Mak NAMARAS,
Presidenti i Bankës Botërore*

VEPRA E SAJ NË ÇDO PIKËPAMJE ËSHTË E JASHTËZAKONSHME

Jeta e Nënë Terezës është dëshmi shembull për të gjithë se çka mund të bëjë një njeri, feja e të cilit është e fortë. Vepra e saj në çdo pikëpamje është e jashtëzakonshme. Bota e sotme gjakon me mall të dyshueshëm kah kjo mirësi dhe dashuri konkrete si e kishte Nënë Tereza.

Philipp Von EDINBURGH, princ

SHIKIMI I SAJ ISHTE SIKUR TË VINTE PREJ QIELLIT

Unë e takova Nënë Terezën. Nuk më kujtohet biseda. E mbaj mend shikimin e saj dhe buzëqeshjen. Ai shikim ishte, sikur të vinte prej së largu këndeje, më mirë të them, prej Qiellit. Buzëqeshja e saj në të e tregonte praninë e atij, i cili, vetë i pasur, e varëfroi veten, që me varfërin e vet t'i pasurojë të tjerët.

Alfred ANCEL, politikan

APOSTULLI I PAQES DHE I DASHURISË

Nënë Tereza ishte një apostull i paqes dhe i dashurisë.

Kumar GUJRAL, kryeministri i Indisë

...NDJEVA SE PO TAKOJA NJË SHENJTORE

Kur ajo hyri në dhomë për të më përshëndetur, ndjeva se me të vërtetë po takoja një shenjtore.

Billy GRAHAM, ungjillizues evangjelist

MISIONET*

Duhet menduar jo vetëm për qytetin tënd, por edhe për mbarë botën. Për këtë qëllim, rajoni i Shkupit i ka shfaqur Zotit shumë zemra fisnikërie. Gjatë jetës së tyre në Shkup, punonin në shoqata dhe dalloheshin për të mirat që i bënin. Gjithnjë mendimi i tyre ka qenë i drejtuar nga misionarët. Nga momenti që shkuan në misione, po edhe tani, shembulli i tyre nxitë idealizmin te të rinjtë.

Nga këto misionare, vlen të përmenden tri vajzat shqiptare: misionaren tani më të njohur Gonxhen, e pagëzuar me emrin e urdhrit fetar Tereza dhe Nasta Mihilit, e cila e shoqëronte deri në Bengal. Vajza e tretë është Ana, e cila mbeti në Jugosllavi, por që vajti shumë larg prej prindërve të saj për t'u bërë murgeshë.

Në fotografinë e paraqitur, shihen dy nga misionaret e sipërpërmendura në momentin kur këto janë larguar prej nesh. E zeza është Nasta, ndërsa e bardha është Gonxha. Rruga për në Bengal zgjat më shumë se një muaj. Gazetat "Misionet Katolike" dhe "Kalendari misionar", shpesh japin nga ndonjë lajm interesant lidhur me misionin bengalik.

Edhe pse jemi katolikë të Serbisë së Jugut, në rrethana të njëjta ashtu si katolikët tjerë, duke pas parasysh se jetojmë mes të pabesintarëve të shumtë, përkrahë shumicës së pashkolluar të popullsisë, jetojmë në kushte më të volitshme, të cilët misionarët tanë në Bengali as përafërsisht nuk i kanë. Së pari, ne nuk jemi aq larg vendlindjes sonë. Gjuha jonë është e

* Shkrim i botuar në revistën "Blagovijest", revistë e katolikëve të Serbisë së Jugut në Mbretërinë e Jugosllavisë, botuar në dhjetor më 1932.

njohur. Manifestimet kulturore dhe veçantit kohore nuk janë të huaja për ne. Krahës kësaj, ndryshimet e mëdha me katolikët e rinj të ardhur, gjithmonë na inkurajojnë dhe na japin forca të reja. Bengali, në të kundërtën është aq larg, sa secili që ka shkuar, ka pak mundësi që të kthehej ndonjëherë.

Broj 8.

„BLAGOVJEST“

Strana 117.

сти играју и поскакивају све док их враг не погуби у пакао. Ове душе треба спасавати, треба Богу довести.

Тако пише Ч. С. Терезија својим некадашњим другарицама у Скопљу:



U, Bengali: Biskup Pišre srod Mesarić-a i Antuna Vizjak, poznati: Udovč, Podražaj, Jas. Vizjak, Drobnic, Šmit. — Masti i Gonda-Terezija srod djece. — Vrazji ples.

„Индијска врућина једноставно пали. Чини ми се да кад околом ходам, под мојим се ногама налази огањ, од којег ми и цијело тијело гори. Кад ми је најтеже, онда се тијешим мишљу, да се душе овако спасавају и да је драги Исус пуно више за њих трпио.

Од кад сам се из болнице вратила, тако пуно имају моје говорити. Све се боје, да им опет не измакнем. Дође једна па каже: „Сестро, зашто Вам је Исус дао сада тако пуно трпјети?“ — Ја јој рекнем, да то није пуно и нека маљко

Vapa e verës është e padurueshme, ndërsa ajri me lagështi. Shumë gjarpërinj, bisha vrasëse, popull i paditur po përgatisin vdekje për misionaret.

At Anton Vizaku, i cili vajti atje në vitin 1927 dhe u bë prift në Bengal dhe e organizoi krahinën misionare të Bengalit, ndërsa tërë Evropën e më së shumti Jugosllavinë e bëri të interesuar për Bengal, u sëmur nga kafshimet e shumta të gjarpërinjve dhe nga mundimet e tjera të misionit, aq sa kryemurgu e thirri të kthehej në Zagreb, për t'ia shpëtuar jetën dhe shëndetin e tij për punë të mëtejshme. Gonxha në Kalikutë ka qenë shtrirë e sëmurë, pikërisht atëherë kur ne i festonim festat e Krishtlindjes. Çdo misionar është i gatshëm ta sakrifikojë jetën e vet për të shpëtuar shpirtrat e pavdekshëm.

Misionarët nisin për në lufta vdekjeprurëse, kur largohen nga shtëpia. Por pse? Ato vërejnë se në mesin e të ligjve, ka të mirë e me shpirt të ndjeshëm. Por këta pa njoh Zotin dhe të papagëzuar nuk mund të shkojnë në qiell. Vallja e djallit, ashtu siç e shihni në fotografi, është aktrim për të vërtetën rrëqethëse se njerëzit të verbuar nga epshet e tyre, luajnë dhe kërcejnë deri atëherë kur djalli ua merr jetën dhe i shpie në ferr. Këto shpirta duhet të shpëtohen dhe t'i dërgohen Zotit. Kështu shkruan murgesha Tereza shoqeve të saja të dikurshme në Shkup:

“Vapa e Indisë thjeshtë të djeg. Kam përshtypjen se kur jam duke ecur, nën këmbët e mia gjendet zjarr, nga i cili më digjet i tërë trupi. Kur ndihem shumë keq, ngushëllohem me mendimin se në këtë mënyrë shpëtohen shpirtrat dhe se Jezusi i dashur për ata ka duruar gjëra më të rënda”.

Pas kthimit nga spitali, të mitë kanë aq shumë për të folur. Të gjithë frikohen, se përsëri do t'u ikë. Vije njëra dhe thotë: “Motër, përse Jezusi Ju ka dhënë kaq mundime?”

– Unë i them, se e gjithë kjo nuk është shumë dhe le të mendojë se Jezusi sa ka durar, atëherë çdo gjë do të duket pak. –

Pas kësaj ajo u largua ... Sërish e pashë pas disa ditësh, e qetë dhe me besim e gjuhëzuar pranë arkës me shkrime të shenjta. Nuk e di nëse ishte duke u lutur ose duke menduar. Pas disa ditësh erdhi sërish dhe tha: “Motër, iu luta Jezusit të më jap durim, sepse e pashë që një gjë e tillë e gëzon shumë Atë, por përveç kësaj, e luta që çdogjë të më duket e pakë, kështu që edhe unë të mbetem gjithnjë e vogël”.

– Në sytë e saj, pashë ndriçimin si yje, me gëzimin e madh shpirtëror, se e mendonte me të vërtetë dhe se ka vullnet të fuqishëm, që ta gëzojë Jezusin po edhe sikur të bëjë sakrifica të mëdha. Që atëherë kaluan tre muaj dhe ajo qëndron në vendimin e saj ... (Vijojnë shembuj të tjerë të bukur nga Bengali).

“Jeta e misionares nuk është e shtruar me trëndafila, por është më shumë me gjemba, edhe kundrejt kësaj jeta e tyre është plot me gëzim dhe lumturi, kur mendon se është duke e punuar të njëjtën punë që e bënte edhe Jezusi në tokë dhe se është duke plotësuar porosinë e tij Shkoni dhe mësoni gjithë popujt! Qëndroni dhe lutuni, ndërsa Jezusi me siguri do t’ju ndihmojë të luftoni për thirrjen e shenjtë ...”

Çdo vit, Kisha e shenjtë cakton një javë, gjatë të cilës duhet menduar seriozisht për misionarët katolikë dhe për njerimin e njerëzve të papagëzuar, Të cilët nuk e njohin Krishtin, kështu që para Zotit janë të përndjekur, më shumë për arsye të paditursë sesa nga arsyeja e qëllimit të keq. Kjo javë misionare mbahet në javën e parafundit të muajit tetor.

Strana 118.

„BLAGOVJEST.

Broj 8.

помисли, koliko је Исус трпио, па не све мало изгледати. — Оде... Видјела сам је за неколико дана, како мирно и побожно клечи пред Табернакулом. Не знам, да ли је молила или само мислила. Послије неколико дана ево је опет, па каже: „Знате, Сестро, молила сам Исуса, да ми да пуно трпјети, јер видим, да то Њега пуно весели, али уза то, да ми увијек све изгледа малено, па да и ја останем увијек малена“. — Из очију сам видјела, које су сјале попут звијезда с пуном духовном срећом, да истину мисли и да има јаку вољу, да Исуса развесели, па макар је стојало тешких жртава. Од тада је прошло већ три мјесеца и она је и даље стална у својој одлуци... (Сљеде други лијепп примјери из Бенгалије).

„Живот мисионарке није посут ружицама, дапаче више трњем; али је уза све то живот пун среће и весела, кад помисли, да ради исти рад, који је Исус на земљи радио и да испуњава Исусову заповијест: Идите и поучавајте све народе! Устрајте и молите се и Исус је сигуран да Вам помогне, да се борите за свето звање...“

Сваке године одређује св. Црква једну недељу, кад треба озбиљно мислити на католичке мисионаре и на биједу некршћених људи, који Христа не познају па су пред Богом погани више због незнања него од зле воље. Ова мисијска недеља одржаје се на недељу претпоследњу у октобру.

Како смо у Скопљу славили мисијску недељу? Према наређењу преузв. госп. бискупа у проповиједима се протумачило, како нам је потребна вјера Крстова. На предавању у вечер у црквеној дворани истакнуто је, koliko има јоште погана на земљи. А ови погани неће се спасти, ако им не помогну кршћани. За сваког кршћанина остају пет или шест погана, да их придобије за Христа. По другим католичким земљама вјерници су прихватили овај од Христа им наложени посао и раде за ширење свете вјере. Шаљу своје синове за мисионаре, сабира милостињу за гоњење кршћане, уче своју струку с добром накомом, да би помогли католичким мисијама. Тако су и у Скопљу некоји приступили братовштини за ширење св. вјере.

По другим жупама наше бискупије за ову братовштину побудило се још веће одушевљење него у Скопљу. Од народа, који не располаже великим новцем те гледи од немаштине, нашли су се многи, да приложе по који дар за обраћење погана. Тврди у својој светој вјери и знајући, колка је срећа бити Кршћанином, хтели су се тиме Богу барем донекле одужити за ову велику благодат.

Тко јоште није приступио овом братству, може то учинити сваки час тиме да се пријави своме жупнику, који ће му казати, како да шири свету вјеру.

Si e kemi shënuar javën misionare në Shkup? Sipas thënies së Zotit të lartmadhërishëm, peshkopi në predikimet ka komentuar, se si na është e nevojshme besimi i Krishtit. Gjatë ligjërinimit në mbrëmje, në sallën e kishës u theksua sa

pabesimtarë të tjerë ka në botë. Këta pabesimtarë nuk do të shpëtojnë, nëse nuk do t'u ndihmojnë krishterët. Për çdo të krishterë mbeten pesë ose gjashtë pabesimtarë që duhen kthyer nga Krishti. Në vendet tjera katolike, besimtarët kanë pranuar këtë punë të përcaktuar nga Krishti dhe e punojnë për të përhapur besimin e shenjtë. Dërgojnë djemtë e tyre për misionarë, grumbullojnë lëmoshë për të krishterët e përndjekur, e mësojnë profesionin e tyre për qëllime të mira, për t'u ndihmuar misioneve katolike. Kështu edhe në Shkup, disa iu bashkëngjiten vëllazërisë për ta përhapur fenë e shenjtë. Në rajonet tjera të dioqezës sonë, për vëllazërinë u zgjua interesim shumë më i madh sesa në Shkup. Nga populli, i cili nuk ka shumë të holla dhe vuan nga uria, dolën shumë njerëz të cilët falën nga ndonjë dhuratë për konvertimin e të pabesëve. Me besim të fortë në fenë e tyre të shenjtë dhe duke ditur se sa e madhe është lumturia nga të qenit i Krishterë, deshën që në një farë mënyre ta falënderojnë Zotin për këtë të mirë të madhe.

Ai që akoma nuk i është bashkëngjitur vëllazërisë, këtë mund ta bëjë në çdo moment, duke u paraqitur tek përfaqësuesi i rajonit të tij, i cili do t'i tregojë se si ta përhapë besimin e shenjtë.



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
 ИНСТИТУТ ЗА ДУХОВНО И КУЛТУРНО НАСЛЕДСТВО НА АЛБАЊЦИТЕ – СКОПЈЕ
 INSTITUTE OF SPIRITUAL AND CULTURAL HERITAGE OF THE ALBANIANS – SKOPJE

Fahu postal 171, tel: +389 (0) 2 3215 381; +389 (0) 2 3215 382; www.itsh.edu.mk; e-mail: kontakt@itsh.edu.mk

Drejtuar:

Kuvendit të Republikës së Maqedonisë
 Qeverisë së Republikës së Maqedonisë
 Qytetit të Shkupit
 Komunës Qendër–Shkup

PROPOZIM

Në ditën kur e shënojmë 105–vjetorin e lindjes së të madhes Gonxhe Agnesë Bojaxhiu – Nëna Terezë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ngre iniciativë dhe e publikon propozimin që në sheshin e Shkupit, aty ku janë themelet e shtëpisë së Nikollë Bojaxhiut, babait të Nënës Terezë, të ndërtohet shtëpia muze e familjes shqiptare Bojaxhiu, që e lindi këtë nënë të madhe të botës.

Tashmë kur është marrë vendimi që të ndërtohet një shtatore e Nënës Terezë në sheshin “Makedonija”, ITSHKSH propozon që – edhe në emër të humanizmit dhe kursimit – ashtu siç dëshironte shpirti i Nënës, ky projekt kaq i shtrenjtë të zëvendësohet me këtë shtëpi muze, e cila do të ishte jo vetëm e mjaftueshme për ta ruajtur kujtimin e Nënës Terezë në Shkup, por njëherazi do të ishte edhe freskim i memories kolektive për këtë shtëpi të rëndësishme të qytetit tonë dhe do të paraqiste shtëpinë më emblematike të Shkupit dhe të historisë së tij.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
"Св. Климент Охридски", Скопје

929Бојациу,Г.

NËNË Tereza - shqiptarja nga Shkupi: (konferencë shkencore-26.08.2015) / [kryeredaktor Sefer Tahiri]. - Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të Shqiptarëve, 2015. - 72 стр. : илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; V. 11)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-27-1

а) Бојациу, Гонца (1910-1997) - Собири
COBISS.MK-ID 99526666